




Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 161, Mars 2017


Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



Dukagjini "Nderi i Kombit"



Profesor
KOLË PRELA
Deputeti historik
i Dukagjinit
NDERI I KOMBIT



Poeti
FREDERIK RRESHPJA
MJESHTËR I MADH

Fjala e Presidentit të Republikës, Z. Bujar Nishani, me rastin e organizimit të veprimtarisë kulturore "Dukagjini, emblemë qëndrese dhe shqiptarie", me Shoqatën Atdhetare "Dukagjini"

3

SHQIPJA NGA FLAMURI THOTË: DUKAGJINI ËSHTË “NDERI I KOMBIT”

Profecia e vjetër se asgjë me vlera nuk dhurohet, vlen më shumë se kudo në këtë rast!

Një vlerësim që e meritonte shumë dekada e vite më pare, një nga borxhet e shumta që Shteti i brishtë Shqiptar i ka Dukagjinit, më në fund u kujtua. Një profeci që qëndronte “de fakto, tani është “de juro”, Dukagjini “Nderi i Kombit”. Kjo ndodhi vetëm fal këmbënguljes të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”. Me datën 23 mars 2017, në ora 18.00, në Presidencë u zhvillua ceremonia zyrtare. Mund të them se është pika kulmore e veprimtarive të Shoqatës ndër vite.

Një eveniment ku ishin aktivistet kryesor të Shoqatës, personalitete të nderuar nga fusha të ndryshme të jetës që i bëjnë nder emrit Dukagjin. Dua të cek që në fillim se edhe në gëzimet tona familjare nuk ja arrijmë ti kemi të pranishëm të gjithë ata që duam, prandaj nëse ftesat nuk kanë mjaftuar për të gjithë na mirëkuptoni. Ju që ishit të pranishëm do ta kujtoni gjate këtë moment historik. Në momentin e duhur ishit në vendin e duhur, ky është privilegj dhe fat.

Me propozim të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, në një dite pranvere, rilindi pranvera e drejtësisë morale të shtetit. Presidenti i Republikës nderoj Zonën e Dukagjinit me urdhrin “Nderi i Kombit”, Profesor Kole Prela (pas vdekjes), me urdhrin “ Nderi i Kombit “ dhe poetin Frederik Rreshpja (pas vdekjes), me urdhrin “Mjeshtër i Madh”.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesia e tij, zoti Bujar Nishani, me dekret nr. 10096, me date 23. 03. 2017 me një motivacion kuptimplotë dhe real vlerëson Zonën e Dukagjinit: *“Për kontributin e shquar të kësaj zone përgjatë historisë së vendit në shërbim të çështjes kombëtare, të lirisë e pavarësisë dhe vendosjes së demokracisë në Shqipëri, si dhe në vlerësim të veprës së figurave të spikatura patriotike e shoqërore, të dala nga gjiri i saj”*

Më poshtë do të jete fjala e plote z. Nishani, vërtet një ekspozitë që na bëri krenar dhe të versuar. Secili nga ne u ndie një personazh me fat, dhe vete Presidenti një aktor që mbuloj neglizhencën e paraardhësve të tij, sepse emrin e vërtet të Dukagjinit e kanë shkruar brezat e tjerë.



Profesor Kole Prela u nderua, me urdhrin “Nderi i Kombit”, pa vdekjes, me motivacion: *“Për rolin e tij si veprimtar i fuqishëm i lëvizjes për çlirim të Shqipërisë, si intelektual i spikatur dhe flamurtar i vendosur i fjalës së lirë e të drejtave të njeriut. Deputeti i parë i Shkodrës, i pushkatuar nga regjimi komunist në vitin 1948, opozitar i palëkundur ndaj diktaturës komuniste dhe martir i lirisë e demokracisë”* Ata që e kanë lexuar, ata që kanë mundur të mësojnë, se kush ishte Profesor Kole Prela, besoj se kanë zor ta quajnë deputet. Ideat e tij për demokraci dhe fjalën e lire nuk ngjasojnë aspak me këta deputetet e sotëm, që disa prej tyre janë kthyer në sharlatan. Puromonistët e vranë ndërsa monistët aktual të shartuar me hibride demokratike e harruan deri tani.

Familjes të shenjte të poetëve të Dukagjinit i dha një martir. Ai kishte lindur poet, kishte lindur i lire, prandaj edhe pse e burgosën dhe e sfilliten në jetë, tani duhet të pranojnë madhësinë dhe pavdeksinë e shpirtit të tij poetik. Poeti Frederik Rreshpja është “Mjeshtër i Madh”, me motivacion *“Për figurën e tij të shquar si mjeshtër i vargut dhe fjalës së lirë,*

si një ndër penat më të ndjeshme e përfaqësuese të frymës lirike të poezisë dhe letrave bashkëkohore shqipe, por edhe për kontributin e tij si publicist e botues”.

Në fund, përshëndeti, Presidentin e Republikës dhe të pranishmit, Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Ndue Sanaj.

Jeta është një lumë që rrjedh, dhe në lumin e historisë të kombit Shqiptar, Dukagjini ka derdhur dallge e stuhi, ka limanet e tij me paqe e melankoli. Nëse Mehmet Shpendi, Zek Jakini, Kole Prela, Sokol Tona e të tjerë e thanë fjalën e duhur në kohën e tyre, është koha që intelektualet e Dukagjinit të marrin përsipër përgjegjësin që ju takon, të përfaqësojnë bashkësinë e tyre ashtu siç e meriton.

Nëse Lin Delia, Pjetër Gjoka, Luigj Marlekaj, Martin Camaj, Frederik Rreshpja, Ndreka Luca, Tinka Kurti e shumë të tjerë e bënë Shqiponjën në flamur të ndihet krenare, ju artiste të Dukagjinit keni rrënjët dhe trungun tek pema e suksesit. Nëse ju duhet pak përkushtim dhe bashkëpunim, mua me duken si gjethe që bien e dalin çdo pranvere. Në këtë orë të vonë tek po shkruaj, instinkti më nxit të mendoj për nesër...! Dukagjini tashmë e ka atë që e meritonte, është “Nderi i Kombit” Ta gëzoni këtë emër kudo që ndodheni. Unë jam i “dënuar”, të them të pathënat...Ky emër është vlerësim dhe përgjegjësi, të bashkohemi e ta mbajmë me nder. Shumë nga ju që merreni me politik ju shoh në dileme, ata lart ju kërkojnë votat, por Dukagjini ju kujton premtimet. Shume nga ju që merreni me biznes ju shoh në krize, kur bëni ato bilancet tuaja mos i harroni dy - tri dromca investimi për kulturën dhe trashëgimin tonë të përbashkët, sepse Dukagjini ju gjykon! Ju që rriini pasiv me idenë për tu bërë qytetar dhe evropian, mos harroni se, më shtrenjtë se i juaji, s’ju blen askush.

Koleg të artit dhe të kulturës, kapitalizmi është një “ujk”, që të veçuar mundet të kafshoj ashpër secilin nga ne. E nesërmja normal është një dite e re, ndoshta më shumë se kurrë duhet të na gjej të bashkuar. Vërtetë kërkohet kohë, përkushtim dhe sakrifice. Këtë e kanë provuar aktivistet e Shoqatës për shume vite. Koha do ju vlerësoj, por Dukagjinit ja kemi borxh.

Gëzuar Dukagjinat! Duajeni njëri - tjetrin, nderoni dhe bashkohuni me ata që shohin larg, sepse ju, të gjithë bashke jeni “Nderi i Kombit”!

Lulash Brigja

Hjala e Presidentit të Republikës, Z. Bujar Nishani, me rastin e organizimit të veprimtarisë kulturore “Dukagjini, emblemë qëndrese dhe shqiptarie”, me Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”

E nderuar zonja Kryetare e Qarkut!

Të nderuar përfaqësues të pushtetit lokal të pranishëm!

I nderuar zoti Sanaj!

Të nderuar përfaqësues të fushës studimore të etnografisë, historianë!

Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë dhe privilegjin që në cilësinë e Presidentit të Republikës dhe në emrin tim personal t'ju uroj mirëseardhjen në Institucionin e Presidentit të Republikës, me rastin e kësaj veprimtarie të organizuar për nder të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Zona e Dukagjinit ka një histori të ndritur luftërash dhe përpjekjesh titanike për liri dhe për mbrojtjen e territoreve nga pushtues të ndryshëm, që shpeshherë kanë qenë të mëdhenj në numër dhe të pamëshirshëm, që kanë vrarë, prerë, djegur e shkatërruar gjithçka, por pa arritur të thyejnë për asnjë çast shpirtin heroik e burrëror të Dukagjinasve kryelartë e syptrembur.

Kontributi Dukagjinit ndodhet në themelet e shqiptarisë dhe ai është shumëplanësh dhe historik, që shtrihet në shekuj, që nga lufta e pandërprerë kundër pushtuesve turq, kundër serbëve e malazezve, që lufta për shpalljen e pavarësisë e udhëhequr nga Ded Gjon Luli dhe Mehmet Shpendi, ku në themelet e flamurit të ngritur në Vlorë është gjaku i 158 luftëtarëve dukagjinas. E për të vazhduar tek lufta e pushtuesve nazi-fashistë, tek qëndresa antikomuniste e me rezistencë të armatosur ndaj tyre.

Kontributi i kësaj treve shtrihet dhe në fushën e jetës politike e shoqërore të Shqipërisë. Sfera e personaliteve të spikatura në art dhe në letërsi që nga Rilindja Kombëtare me piktorin e talentuar Noc Martin Camaj, deri të albanologu i shquar Martin Camaj, piktori Lin Delia, që nga kardinali Mikel Koliqi, e deri te profesori Luigj Marlekaj, që nga Zef Hilë Gega e deri të Artistja e Popullit Tinka Kurti, që nga Mjeshtri i Madh i sportit Dodë Tahiri e deri te Mjeshtri i Madh Lin Shllaku e plot e plot të tjerë, të cilët mund t'i rendisim në listën e gjatë të këtyre emrave e personaliteteve të mëdha që Dukagjini i ka dhënë kombit shqiptar dhe plotë të tjerë.

Të dashur miq, asnjë fjalim në fakt, nuk do mjaftonte për të folur për Dukagjinin, për historinë e tij, për traditat, për zakonet, kulturën, artin e të tjerë. Dukagjini ka qenë kështjellë e malësorëve trima dhe krenarë, e martirëve të besimit, ku në qendër ka qëndruar pa ndërprerje arqipeshkvia e Pultit. Dukagjini, por dhe Mirdita janë dy zonat e vetme shqiptare që arritën t'i mbijetojnë ndryshimit të strukturës së besimit në Shqipëri, gjatë rrjedhës së shekujve.

Sikur të mos mjaftonin përpjekjet disa shekullore për mbrojtjen e vatrave dhe të besimit, vendosja e diktaturës komuniste që një ogur i zi duke sjellë martirizimin e shumë klerikëve dhe besimtarëve duke i vrarë dhe duke i burgosur ata. Është në nderin tonë që të përmendim këtu të martirizuarit: At' Bernardin Palaj, At' Çiprian Nikaj, Dom Lazër Shantoja, At' Gjon Shllaku, apo klerikët e burgosur si At' Pjetër Meshkalla, at' Gegë Lumaj, At' Frano Kiri, At' Mark Shllaku, Dom Ndoc Nikaj, Dom Nikollë Shllaku, dom Nikollë Gjini, Dom Dedë Plani, Kardinalin Mikel Koliqi, shumica e të cilëve u shpallën martirë të kishës katolike shqiptare nga Ati i

Shenjtë Papa Francesku.

Por Dukagjini si emblemë e qëndresës ka ecur kryelartë e ballëhapur duke u bërë krenaria dhe dinjiteti i patjetërsueshëm i të gjitha sfidave dhe dallgëve me të cilat e ka përplasur historia. Duke mbërritur në vitet e lirisë e të demokracisë si një thesar i çmuar e i pashtershëm vlerash, traditash që duhen ruajtur e vlerësuar pareshtur.

Të nderuar pjesëmarrës!

Do të ishte e pafalshme nëse sot nuk do të flisnim sadopak edhe për bukurinë e sertë, por magjepsëse të natyrës me të cilën Zoti ka bekuar zonën e Dukagjinit. Është një bukuri përrallore që mahnit këdo për peizazhet e rralla që janë bërë shpesh burim i legjendave me zana mali si personazhe, që me sa duket kanë fatin dhe privilegjin që të jetojnë mes

të bëjnë shumë sakrifica, por një gjë kurrë s'e kanë negociuar, një gjë kurrë se kanë dorëzuar, NDERIN! Andaj sot është më e pakta që institucionet e shtetit shqiptar, shoqëria shqiptare, qytetarët shqiptarë në tërësi të bëjnë që në kujtim, nderim të kësaj sakrifice, këtij rrugëtimi historik, këtë nder të atyre burrave e grave, të këtyre malësorëve historik ta kthejmë në një falënderim e një mirënjohje, dekoratën “Nder i Kombit” për zonën e Dukagjinit, për kontributin e saj si trevë me veprimtari të fuqishme dhe të përhershme në shërbim të kombit, për liri e pavarësi, për çlirim kombëtar e shoqëror dhe vendosjen e demokracisë në Shqipëri. Unë mbetem shpesh plotë se ja kemi dalë mbanë sadopak gjatë këtyre kohëve për ta vlerësuar këtë zonë ashtu siç ajo e meriton,

Një poet lirik, eseist, publicist, botues, penda e të cilit është ndër më përfaqësueset e vargut shqip. Mjeshtër i pashoq i penës dhe i fjalës së lirë dhe për këtë u persekutua gjatë gjithë jetës së tij tragjike dhe u dënua si kundërshtar i dogmës komuniste, i mungesës së lirisë, sistemi diktatorial e cilësoi si person që paraqiste rrezikshmëri dhe synonte minimin apo dobësimin e atij që siç thuhej në atë kohë “Pushtetit Popullor”. Por diktatura e egër nuk ja doli kurrë që të thyente shpirtin e pamposhtur apo t'i luhaste fillin e mendimit e pastaj jo më ta bënte atë të heshte, të heshte vargun e tij të fuqishëm e tronditës. Ndaj unë mendoj që duke njohur mjeshtërinë e penës, mendjes, dhe zemrës së Frederik Rreshpes, sot nuk bëjmë gjë tjetër veçse e vendosim atë në pedestalin e merituar që i takon duke e kujtuar gjithmonë si Mjeshtër të madh.

Ka mjaft personalitete kjo trevë, e kjo jo vetëm që nuk na lodh kurrë që t'i përmendim, që t'i rendisim emrat e tyre, punën e tyre, veprën e tyre, kontributin e tyre, përkundraz sa më e madhe kjo listë aq më e lartë përgjegjësia e shtetit dhe institucioneve të shtetit, sa më e gjatë kjo listë aq më e madhe është vlera e kësaj treve e kësaj zonë. Prandaj unë dëshiroja që së bashku të njohim dhe vlerat e spikatura të profesor Kolë Prelës, të cilët së bashku me Frederik Rreshpen dhanë një kontribut të madh për Dukagjinin, për fushën e politikës, kulturës, artit dhe qëndresës, qëndresës së një diktature të egër, e cila për fat të keq ende përpëllitet, përpëllitet kudo si fantazmë, si hije, por ndjellakeq dhe synon të vrasë ende shpirtin dhe mendjen e njerëzve. Por unë jam i bindur që nuk mundi dot të ndalonte mendjen, zemrën, e shpirtin e këtyre njerëzve, të cilët sot kanë lënë dhe trashëgimi, kanë lënë dhe pasuri, kanë lënë dhe inspirimin, kanë lënë dhe shembullin dhe modelin e tyre. Nuk besoj që do ketë mundësi e hapësirë për këdo që të hyjë dhe të fusë në mendjen e shpirtin e dukagjinasve e të gjithë shqiptarëve hijen e zezë të së shkuarës, frikën dhe mungesën e së drejtës për të thënë të vërtetën.

Uroj sonte që Dukagjini e dukagjinasit të kenë jetë të lumtur e të begatë, t'i gëzojnë sot e përjetë frytet e përpjekjeve dhe sakrificave të tyre të bëra këtu në shekuj dhe jam i bindur që do mbesin si trashëgimi në shekujt që vinë.

Uroj sot nga kjo sallë për secilin prej jush, për familjet tuaja, por edhe për të gjithë dukagjinasit kudo ku ata janë në Shqipëri apo në botën e madhe që sot i ka përpirë edhe shqiptarët, të kenë bekimin e Zotit dhe të kenë mbarësi në vatrën e tyre! Kurrë të mos e harrojnë trollin e tyre, kurrë të mos e harrojnë origjinën e tyre! Kurrë të mos e harrojnë historinë e tyre! Kurrë të mos i harrojnë sakrificat e të parëve të tyre, sepse vetëm mbi bazën e tyre e mbi kujtimin e tyre do jenë gjithmonë të fortë për të tejkaluar çdo hall, çdo problem, çdo vështirësi që natyrshëm njeriu ndeshet në jetë, por duke pasur këtë fond të madh trashëgimie të shkëlqyer nuk ka vështirësi që nuk do ta tejkalojnë!

Ndaj dhe njëherë Zoti e bekoftë Shqipërinë! Zoti bekoftë shqiptarët!

Zoti e bekoftë Dukagjinin, këtë perlë të trolit shqiptar!

Zoti i bekoftë dukagjinasit kudo ku janë!”



këtyre kreshtave malesh mbresëlënëse. Burimet e kulluara të ujit, që shushurijnë dhe rrjedhin lirshëm dhe natyrshëm në shtatin e tyre natyror, të papenguar nga ndërhyrjet e industrive, pyjet që gjelbërojnë atë pejzazh te papërsëritshëm, dhe Alpet që qëndrojnë lartë hijerëndë e kurorëzojnë gjithë këtë bukuri të pamasë e të rrallë që Zoti i ka falur jo vetëm asaj krahinë, por gjithë trolit shqiptar. Thethi, Shala, Shoshi, Pulti, Temali e Shllaku kush e kush më i bukur se tjetri. Natyra ka dhuruar edhe pyjet me gështenja që rriten të bollshme në ato anë si për të treguar se bujaria e saj nuk ka pasur të sosur në ato anë.

Dukagjini është një zonë që duhet të jetë në zemër të turizmit në Shqipëri në mënyrë që njerëzit, turistët e vizitorët t'i shijojnë këto bukuri të virgjëra të natyrës, por edhe Dukagjinasit të përfitojnë punë dhe të ardhura që të jetojnë ashtu siç e meritojnë në lumturi e prosperitet që kjo të jetë edhe një shpërblim për sakrificat e tyre shumë - shekullore për t'i mbrojtur ato anë.

Të nderuar të pranishëm!

Në cilësinë e kreut të shtetit kam privilegjin, por edhe detyrimin institucional që jo vetëm të njohim këtë rrugëtim historik edhe këto kontribute të jashtëzakonshme e sakrifica të bëra nga breza e breza të shumtë të asaj treve, gjyshër e stërgjyshër të gjeneratave të sotme, të cilët kanë pasur shumë vështirësi, kanë pasur shumë pengesa, u është dashur

duke i dhënë vendin që i takon. Edhe përmes vlerësimeve, njohjeve, dhe angazhimeve institucionale të shtetit shqiptar.

Por padyshim që kjo krahinë, kjo trevë, kjo legjendë, përveç atyre emrave të mëdhenj, të burrave që unë përmenda, vazhdon të jetë pjesë e dinamikës më të mirë të kombit shqiptar dhe trolit shqiptar. E unë jam i bindur që në traditën më të mirë të kësaj zone, të historisë së saj, të genit të saj, të trashëgimisë së saj, do vazhdojë t'i japë gjithmonë vendit, do vazhdojë t'i japë gjithmonë kombit, kontribute të jashtëzakonshme njerëzish, të cilët me zemrën, mendjen, e kapacitetin e tyre, mbi të gjitha patriotizmin e dashurinë për vendin për trolin do vazhdojnë të ndjekin rrugën e të parëve të tyre.

Dua sonte të dashur miq që në njohje të këtyre përpjekjeve t'i adresojmë një nderim të veçantë, në shenjë kujtimi e mos - harrese, por edhe vlerësimi, profesor Kolë Prelaj, i cili si një veprimtar i fuqishëm i Lëvizjes për Çlirimin e Shqipërisë, si një flamurtar i vendosur i fjalës së lirë dhe intelektual i spikatur, deputeti i parë i Dukagjinit dhe i Shkodrës, i cili u pushkatua nga regjimi në vitin 1948, i njohim nderin që i takon duke e vendosur edhe atë në pedestalin e nderit të kombit shqiptar.

Në këtë ceremoni të thjeshtë, por kuptimplotë, nuk kishte si të mungonte edhe respekti edhe nderimi për artistin dhe krijuesin me shpirt të paepur Frederik Rreshpa.

Hjala e përshëndetjes nga kryetrari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"



I nderuar zoti President, Shkëlqesia e juaj, zoti Bujar Nishani!

E nderuara Kryetarja e Këshillit të Qarkut Shkodër, zonja Gerta Bardeli!

I nderuar N/Kryetari i Bashkisë Shkodër, zoti Arben Gjuraj!

Të nderuar te pranishëm!

Është nder e privilegj, që në cilësinë e kryetarit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", marr sot, prej Jush dekoratën e lartë "Nderi i Kombit" për Dukagjinin.

Me këtë rast, në emër të Shoqatës dhe besoj të gjithë dukagjinave kudo ndodhen, ju falënderoj për vlerësimin e lartë, për nderimin e veçante që na bëtë.

Nder e mirënjohje për ju dhe punën

tuaj!

Zoti President, më lejoni, që të falënderoj autoritetet e pushtetit vendor të Qarkut Shkodër, për mbështetjen që na kanë dhënë në gjithë punën e shoqatës, për realizimin e misionit të Saj, në veçanti Kryetaren e Bashkisë Shkodër, zonjën Volana Ademi, që na ka mbështet propozimin që ju kemi bërë, për këto dekorime.

Institucioni i Presidentit të Republikës ka qenë gjithnjë i vëmendshëm dhe i gatshëm për nderimin e personaliteteve më të shquara të Dukagjinit në shërbim të kombit tonë, që kanë dhënë kontribut të çmuar për Shqipërinë.

Edhe këtë radhe Ju u treguat i gatshëm, u treguat i vëmendshëm, jo vetëm për

nderimin e personaliteteve dukagjinase, si të profesor Kole Preles, me urdhrin "Nderi i Kombit" dhe poetit Frederik Rreshpja, me urdhrin "Mjeshtër i Madh", pas vdekjes, por në veçanti për nderimin e Dukagjinit, sepse me këtë nderim, me urdhrin "Nderi i Kombit", u nderua gjithë bashkësia dukagjinase, historia e tij, kontributi i tij, përpjekjet e tij për ruajtjen e gjuhës, të kulturës dhe të identitetit kombëtar në kohet më të errëta të historisë, me një qëndresë të jashtëzakonshëm ndaj të gjithë pushtuesve.

Ky nderim dhe ky vlerësim i lartë nga ana e Juaj na angazhon edhe më shumë, që të mos kursejmë asgjë, që edhe sot të japim kontributin tonë, sado modest, për Shqipërinë tonë të lirë dhe demokratike, të zhvilluar dhe të përparuar, të integruar dhe moderne, me dinjitet në bashkësinë e kombeve të tjera të qytetëruara.

Ju faleminderit!

Një dosje e pezulluar një jetë sociale e pezulluar: reformë në drejtësi apo drejtësi tranzitore në Shqipëri?



Në përpjekje për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian, shteti ynë, aktorët përkatës dhe shoqëria shqiptare po përpiqet në dukje t'i adresohet të gjitha çështjeve të drejtave të njeriut duke përfshirë të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore nëpërmjet thirrjes sociale për të bërë reformë në drejtësi.

Duke marrë shkas nga kjo dhe e shtyrë nga pjesëmarrja në një seminar të titulluar "Dosjet e pezulluara kundrejt reformës në drejtësi", të organizuar nga Shoqata "Youth Development Group", Tiranë në të cilën ishin të pranishëm studentët të Juridikut dhe aktivistë social, u nixta për të shkruar këtë artikull: Vërtet sa dosje të pezulluara janë aktualisht nëpër Gjykatat tona, të cilat lënë pezull jetët njerëzore?? Përse lihen të pezulluara?

Për të diskutuar në lidhje me një çështje të tillë e ftuar ishte gazetarja Zj. Nikoleta Kovaçi, e cila vuri në dukje se shteti ynë është në një kolaps: duket sikur reforma në drejtësi do e zgjidhë problemin tonë, por në të vërtetë reforma ka nevojë për njerëz, për ne që e duam drejtësinë dhe jo ti besohet një pale partiake ku dominon falsiteti dhe korrupsioni. Për të bërë një reformë të mirëfilltë nevojitet edhe kohë fizike që të kohë për menaxhimin e plotë të procesit.

Për më tej vuri në dukje se për të pasur tamam drejtësi, ndër të tjera media duhet të jetë e lirë pasi jo rrallë ndodh që kur gazetari futet në skuta të errëta për të zbuluar se çfarë është duke ndodhur dhe si ka ndodhur, përfundon keq ose kalon rreziqe me jetën.

Më konkretisht, Zj. Kovaçi iu referua një dosje të pezulluar ku një djalë është varrosur i gjallë dhe ka qëndruar i gjallë për 48 orë në Mat: Çështja është në Gjykatën e Apelit, ndërsa personat që janë dënuar vijojnë nga 10 deri në 17 vite, ndërsa familja nuk ka ku të ankohet duke përmendur faktin ndër të tjera që ishte një djalë i vetëm. Në këto raste a mund të flitet për mundësi amnistie? Nga këndvështrimi psikosocial, dështimi për të realizuar të drejtat humane në aspektin ekonomik, social dhe kulturor si dhe dhunimi ndaj këtyre të drejtave mund të jenë dhe zakonisht janë pjesë e rrënjës që shkakton konfliktin, fenomenet e errëta sociale dhe represionin procesin e të jetuarit. Për më shumë, veprime të tilla kanë ndikim mbi ato shtresa që janë më të prekshme sikur në rastin e mësipërm. Le të pyesim sërish, sa çështje jetësore mbeten të pazgjidhura duke lënë pezull shumë aspekte jetësore? Vërtet për ti thënë ndal ndodhive të tilla në dukje të parë nevojitet një reformim në drejtësi. Por a mund të kemi reformë në drejtësi pa kaluar me sukses në fillim drejtësinë tranzitore? Le të bëjmë një krahasim të të dyjave:

Së pari, rregulli i programit të reformës në ligj është një fenomen më global i mbështetur nga një numër agjencish dhe vendesh, dhe racionalizohet në bazë të zhvillimit ekonomik, demokratik dhe paqes. Qasja e tij ndaj çështjeve të reformës dhe rindërtimit të një sistemi ligjor është në tërësi plot nuanca, sidomos për një vend post tranzitor sikur është vendi ynë. Prandaj për të bërë një reformë të tillë nevojitet të merret parasysh zhvillimi ekonomik, demokratizimi, reduktimi i varfërisë dhe ndërtimi i paqes.

Referuar këtyre të fundit, secili prej nesh është i ftuar për të bërë një analizë vetjake, sa u është zgjidhur problemi i papunësisë, sa demokratë jemi në realitet në trajtimin dhe ndërhyrjen e çështjeve jetike, në mbështetjen e shtresave të marginalizuara dhe sa po reduktohen konfliktet familjare, sociale dhe politike?

Së dyti, drejtësia tranzitore ka ambicien pozitive për të ndihmuar shoqëritë

e shtypura dhe për ti bërë ato të lira duke iu adresuar padrejtësive të bëra në të kaluarën që do të prokurojnë një të ardhme të barabartë. Kjo pasi duhet punë për të arritur dhe shkuar përtej krimeve dhe abuzimeve të kryera gjatë konflikteve që kanë çuar në tranzicion dhe duhet ti adresohet dhunimit të të drejtave humane dhe shkaqeve që kanë kontribuar në to.

Po ti referohemi kësaj drejtësie sërish kemi sfidën që të mund të ngremë pyetjet të tilla, si në vijim:

(a) Cili është mekanizmi potencial i drejtësisë tranzitore për t'iu adresuar çështjeve jetike si fillim?

(b) A janë këto mekanizma funksionalë të përshtatshëm për t'ia dalë mbanë?

(c) Si mund të lidhet më së miri drejtësia tranzitore me të drejtat ekonomike, shëndetësore sociale dhe kulturore?

(d) Çfarë parimesh duhet të udhëheqë përfshirja e drejtave ekonomike, shëndetësore, sociale dhe kulturore në proceset e drejtësisë tranzitore?

(e) Cilat pengesa duhen kaluar?

Duke pasur parasysh që të drejtat ekonomike, shëndetësore, sociale dhe kulturore janë pjesë e kornizës ligjore të drejtave universale humane, në të cilën të gjitha të drejtat janë universale, të ndërvarura dhe të ndërlidhura, atëherë a mund të themi që drejtësia tranzitore mund të jetë një pjesë kryesore e reformës në drejtësi? Kjo, pasi këto të drejta ndërtojnë kushtet minimale të kërkuara për njerëzit që të jetojnë në një mënyrë dinjitoze, për të siguruar lirinë nga frika dhe dëshira, dhe përmirësim të vijueshëm të këtyre kushteve.

Lidhur me këtë të fundit, dëshiroj të ndalem pak duke cituar Prof. Asoc. Dr. Jordan Daci, i ftuari kyç në këtë seminar, i cili theksoi që duhet të jemi të përgatitur si shoqëri për të bërë reformën në drejtësi pasi vetë shoqëria jonë nuk është në gjendje të prodhojë një standard të ri. Përveç kësaj duhet të kemi kujdes nga drejtësia represive. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë që thjesht të jemi në rregull

me reformën në drejtësi...

Prandaj, sërish i rikthehem drejtësisë tranzitore... A do ishte e përshtatshme që vendi ynë të fillojë me këtë? Në thelb, drejtësia është një përpjekje e përjetshme për tu dhënë të gjithëve atë që u takon... Prandaj për këtë, hyn koncepti i realizimit progresiv që përkrahur një aspekt qendror të obligimeve të shtetit në lidhje me këto drejta sipas të drejtave ndërkombëtare humane. Ndërkohë një që realizimi i plotë i këtyre të drejtave nuk mund të arrihet menjëherë dhe kërkon kohë në mënyrë që të gjithë aktorët të marrin masat e nevojshme drejt realizimit të plotë të burimeve të mundshme. Pra, le të besojmë që jemi duke u përgatitur, por nevojitet vetëm pak kohë më shumë...

Edhe pse tashmë ka një fokus në rritje mbi reformën në drejtësi, ka pak udhëzime mbi si ta qasim një rregull të reformës në drejtësi, dhe si strategjitë e adoptuara të ndryshojnë në përshtatje me vendin tonë. Kjo pasi sipas Mani (2002), janë dy kategori në kontekstin e një vendi në zhvillim: kategoria I korrupsioni dhe mosfunksionalizmi, kategoria II: e paligjshme, por funksionale. Të gjitha këto përmblen atë që në një masë ekstreme paraqesin karakteristikë të një paqaje akute, një mungesë të kapaciteteve profesionale dhe burokratike, një kulturë inflamtoze dhe të dhunshme të kulturës politike dhe një shoqëri të shpërndarë dhe shumë të traumatizuar nga çfarë ndodh.

Në mbyllje të këtij artikulli, dëshiroj të theksoj një ftesë të hapur për të gjithë, me qëllim që të fillojmë të punojmë si agjentë të ndryshimit, ne duhet së pari të jemi në gjendje të kemi vizionin e një shoqërie bazuar në parime të barazisë dhe drejtësisë sociale për të gjithë. Është në mënyrë kritike e rëndësishme të fillojmë për të krijuar hapësira për drejtësinë tranzitore apo reformën në drejtësi që të gjithë njerëzit të gjejnë zërin e tyre, të ëndërrojnë dhe të krijojnë një vizion, që është i vërtetë për ta dhe bazohet në një dosje të hapur/transparente të të drejtave universale humane.

SUELA NDOJA

NDER DHE RESPEKT PER POPULLIN E TEMAL DUSHMANIT

- Kujtime -

(Vijon nga numri i kaluar)

Aq sa ishte i rëndësishëm mësimi në shkollë, po aq ishte edhe lufta kundër analfabetizmit për të luftimin e të cilit punuam me shumë kujdes dhe përkushtim. Të gjithë nënë moshën 40 vjeç, duhej të mësonin shkrim e këndim duhej të arrinin të mërrnin deftesën e liritimit të shkollës 8 vjeçare.

Për shkollën pa shkëputje nga puna një kontribut shumë të rëndësishëm ka dhënë Zef Pjetër Deda, në fillim mësues aksionist në kooperativën bujqësore të Shllakut, pastaj drejtor shkolle në Kodër Nikaj dhe i zonës së Shllakut. Ky u zgjodh deputet për në Kuvendin Popullor në vitin 1970. Mbi 140 veta morën dëftesë liri mi për klasën e VIII në vitin shkollor 1972-1973. Ku burrë ndikoj shumë në qeveri për këtë zonë. U hap shkolla e mesme bujqësore me konvikt, u ngrit shtëpia e kulturës që gjallëroj jetën kulturore artistike në krahinën e Shllakut. U ndërto spitali i Shllaku me mjekun e parë Mërzuk Hoxha dhe më vonë Ndue Nika. Ky spital kishte edhe infermier, mami dentist Ndoc Berisha, etj. U hap libreria, qendra postare, centrali telefonik që mbulonte të gjitha krahinën. Në shtëpinë e kulturës shfaqej fil çdo jave, po kështu edhe në fshatrat e tjerë, shfaqej film 4-5 herë në vit. Kinooperat ishte Gjergj Dinelli dhe më vonë Halil Astragu. U ngritën dyqane më artikul të përzier në tërë krahinën. Të gjitha këto e të tjera që u realizuan kishte punën e drejtuesve të organeve vendore, por një ndihmë të veçantë dha deputeti Zef Deda.

Në zonën e Temal-Dushmanit, në qershor të vitit 1973 përfundoj elektrifikimi i fshatrave. Deri në këtë kohë kemi shkruar dhe lexuar nën dritën e pishës dhe të kandilit me vajguri. Marrë informacionin e kemi me anë të radiove me bateri që një të tilla na e kishte blerë këshilli i fshatit edhe ne mësuesve.

Në atë kohë edhe ndërmarrjet shtetërore kishin në patronazhe kooperative bujqësore, veçanërisht në zonat më të varfëra.

Kujdesi për nxënësit dhe shëndetin e tyre ishte në nivelin maksimal në kushtet që ishin. Bëheshin 3-4 herë vizita të oragnizuara mjekësore në shkolla, si nga mjekët e infermierët e spitali, nga dentisti Ndoc Berisha, që së bashku me mësuesit ndikonin në përmirësimin e kushteve të higjienës dhe pastërtisë si dhe të gjendjes shendetësore në krahinë. Ne prositnim nxënësit që çdo të hënë të vinë të larë vetë dhe me rroba të lara, bëheshin kontrole për higjienën personale dhe komunikim me prindërit, natyrisht me shumë kujdes dhe mirësjellje për të mos u ndjerë të fyer. Porositnim që djemtë të vinin në shkollë me flokë të shkurtër, me qëllim që të mund të kishin më shumë mundësi pastërtie. Një nënë, për të re-

alizuar porosinë e mësuesve, nuk kishte gërshtë dhe ja shkurtton djalit flokët me flakën e bishtikut. Për të zbatuar fjalën e mësuesit. Sot kjo duket rrëqethëse, por tregon se sa vend zinte fjala e mësuesit.

Mbarëvajtja e punës mësimore- edukative, zanafillën e ka te harmonizimi i marrëdhënieve të shëndosha shkollë-familje dhe anasjelltas. Po tregoj shembuj nga puna kur unë punoja atje për 7 vite.

- Nuk mbaj mend asnjë rast në këto vite që të kemi filluar mësimin pa libra në shkollë ne ditën e parë të saj. Fshatarët nga Cukali në shkollë i bartnin mbi shpinë, shprehje, kjo, që tregonte kujdesin dhe vlerësimin e shkollës për fëmijët e tyre.

- Në fillim kishim mugesë në ushqime, bukën e merrnim në Shkodër. Kur nisi të organizohej koop. bujq. na shpërndanin misër apo miell, por na mungonin kushtet oër ta gatuar bukën. Nana e Madhe Prëndë Zefja kishte gjashtë jetima, më i madhi ushtar dhe më i vogli në klasë të parë, i shton vullnetarisht vetës edhe 7 mësues të Telumës dhe duke mos pranuar asnjë lek për shërbimin që na bënte.

- Lulë Ndoja ndanë bukën e fundit përgjysëm me arsimtarët dhe fëmijët e saj.

- Pal Gjon Nika me bashkeshorten Katrinë Dedja, më 1973, me qënë se ra shumë borë dhe mësuesi mbeti i bllokuar pasi nuk kalohej, e strehojnë në shtëpinë e tyre, e ushqejnë. Në fund mësuesi i thotë: Pali, që për dy javë që e mbajti në shtëpi sa para duhej të pagunte. Pali i përgjigjet shkurt e prerë: "Boll mirë ndëje dhe boll keq fole".

Lidhja jonë me fshatin ishte e shkëlqyer, konsideroheshim si vëllezër. Na thirnin në dasma, na lajmëronin për morte, madje aq e shkëlqyer ishte lidhja jonë sa që asnjë keqkuptim apo mosmarrëveshje nuk ndodhi. "Hajde Shkodër i pari me la duar për tu ulur në sofra". Në varrime vendosnin kryqin në praninë tonë. Kur i pyetnin se si ishin, a punonin etj, ata përgjigjeshin: "ça punojmë e din Partia", "Jena mirë e këna boll me dashtë me rrëjtë", e shembuj të tjerë, as për servilizëm, as për neglizhencë, dhe as për liberalizëm, por e kuptonim mirë njëri tjetrin, e kuptonim se qëllimi nuk ishte keqdashës, që e tregon fakti që për shtatë vjet që qëndrova në Telumë nuk u shënu asnjë incident në mes mësuesve, nxënëseve, prindërve, apo fshatit.

Me punën e mësuesve dhe të nxënëseve, ndihmën e fshatit dhe mbështetjen e seksionit të arsimit Shkodër e Kom ekz, të k.p. të Rrethit Shkodër arritëm të kemi një bazë materiale mësimore në shkollë të plotë, që u ngrit nga hiçi. U ngritën klasat kabinet ku konkretizoheshin të gjitha mësimet në klasë.

Pranë shkollës u ngrit biblioteka e shkollës me mbi 1000 copë libra, natyrisht edhe politikë sepse e tillë ishte kohë,

por kishte shumë më shumë libra të karakterit artistik, metodik dhe libra për fëmijë.

Punë e madhe u bë edhe në luftën kundër analfabetizmit, gjë që e tregojnë edhe pasqyrat zyrtare të këshillave të fshatrave të kohës.

Ishte një detyrë për kohën, lidhja e mësimit me punën dhe kalitjen fizike. Kalitja bëhej çdo dotë nga vetë nxënësit duke ardhur dhe duke u kthyer nga shkolla, që arrinte mbi 2-3 orë rrugë çdo ditë.

Çdo javë këndohej himni kombëtar dhe bëhej përshëndetje: "Në luftë për çështjen e Partisë dhe të Popullit të jemi gati", nxënësit të gjithë njëheri dhe fuqishëm përgjigjeshin: "Gjithmonë gati", pastaj futeshin me rregull në klasa për mësim.

Në atë kohë vlerësohej puna prodhuese e shkollës, por edhe ndihmonte kooperativën bujqësore në mbledhjen e prodhime bujqësore veçanërisht, si në pastrimin e barit nga qepujkat, pastrimin e saj kur shkulej, mbledhje gështenjash, zhveshje misrit, mbledhje groshe, etj.

Mendoj se nuk do të ishte i plotë ky informacion pa i përshëndetur ata burra dhe burresha që punuam bashkë, që ndanë kafshatën me ne dhe arritëm suksese. Në mes tyre veçoj katër kryetarët e këshillave të fshatrave bazë Pal Dedoshi, Gjëllosh Zhuri, Nikë Sokoli dhe Gjon Ndreka. Po kështu do të ishte i mangët po të mos përmendja emrat e shumë familjeve, mase ndonjë e kam harruar por u kërkoj fale publikisht.

Në Telumë

Gjergj Camaj, Zef Camaj, Mark Camaj vëllezërit dhe nipat Mirashi dhe Prella të të madhit Martin Camaj, Pal Gjon Nika, Luigj Gjon Zhuri më vëllezërit Zefi e Ndoja dhe kunatën Sose, Ndue Brushtulli tek Markonët, vëllezërit Kolë e Palë Prendushi në Siraç, Ndue Kolë Voci me pesë djemtë Prendushi, Preka, Marku, Kolë dhe Pjetri, Pashuk Zefi, Martin Bulshani me katër djemtë Kola, Gjergji, Tushi dhe Vata, Shkurte Dedja me vjază, burrin e aratisur në Londër, Mark Prendush Zymeri me vëllezërit Kolën, Zefin, Gjonin, dhe bashkeshorten e tij Prënda e cila çonte gështenja të pjekura dhe të qëruara për rrugë kur uleshim në Shkodër, Dedë Martin Bashota, roje e depos se armatimit dhe dali Ndoci brigadier, Nikë Gjon Nika sekretar i partisë në fshat dhe vëllaun e tij Ndoja.

Në Malagji

Zef Gjergj Hila, Ndoc Kolë Molla, Pjetër Koleci me pesë djemtë; Ndoja, Kola, Lulashi, Marku dhe Martini, Dedë Zefi i dashur dhe i respektuar në veçanti dhe vëllaun i tij Mhill Zef Çaranishti dhe "Nana e Madhe" që këta djem i thirrnin "Cicë", Gjokë Pal Ahi me djemtë Pjetrin dhe Prelën, Kolë Zefi dhe vëllaun i tij Toma "i madh sa Prek Cali", Vatë Gjëlloshi që

vdiq nga rryma elektrike dritë pastë, Cin Gjëlloshi, Ndue Gjëlloshi, Ndocë Gjëlloshi dhe Prekë Gjëlloshi në Rripë, plaku i vetëm Market Deda që na dhuronte arra, Tomë Sokoli dhe Nikë Sokoli, parash Pali dhe Zef Guri, Kin Marku burrë i vjetër me gruan e tij Bjeshtë, Kolë Pjetër Rrasa, Gjon Deda, vëllezërit Fran e Dedë Curri, ky Deda ishte humoristi jonë, i thonim sa i tashë je more Dedë, sepse ishte i shëndoshtë, ai na përgjigjej "më të trashë kam vëllanë". Ky humor bëhej gjatë kohës së lirë kur vazhdonin shkollën e mbrëmjes.

Në Kajvall

Ndue Mirash Delia, shtëpijak i mirë që vazhdimisht na dërgonte shishe më raki dhe shporta me rrush, Kolë Zhuri me djemtë Deda që punonte përgjegjës tregëtie në Cukal, Zefi elektrikist dhe Gjëlloshi kryetar i këshillit të fshatit, Zef dhe Tomë Delija, Ndue Pali, Mark Milani kovaç, Kolë Bala, Gjergj Cama, Prekë dhe Mark Shytan Cani, Ndue Marku Nënplep, shumë larg me fshatin, afër Gurit të Lekës, por që e ndante Lumi i Shalës.

Në Klllogjën

Pal Dedoshi kryetar i këshillit të fshatit, Zef Toma, Mark Ndoja, Kolë Pjetër Selimi me shtëpi të bukur dhe ekonomi të mirë, Lulash Martini dhe vëllaun i tij Vatë me bashkeshorten e tij Sykën, Nosh Marashi dhe djali i tij Zefi që u bë mësues, Kolë Murreci me dy djemtë Palin dhe Gjëlloshin, Gjon Frroku, Gjon Thana, Mark Ndoja elektrikist, Zef Prendi dhe Kolë Gjoni në Volaj, Kolë Prekën, Nikë Marashin me qeleshe të bardhë, Nikë Lulashin, etj.

Në Vilë

Nikë Sokoli kryetar këshilli i fshatit, Lulash Sokoli, Vëllezërit Deda, Pashuku dhe Llesh Mark Voci, ky i fundit ish sekretar partie, Ndoc Keqi ish mësues në fshatin Vilë kohë më parë, vëllezërit Shuk e Mhill Ndoja, Ndue Preka, Pjetër e Rrok Pjetrushin, Gjon Mandi mirëmbjtës i linjës telefonike, Gjëllosh Doda elektrikist, Pal Prendushi, Ndoc Guri brigadier, Kolë Marku me fëmijën e vetëm vajzën Age.

Unë mbaj mbi shpatulla 70 vite dhe jam larguar prej 40 vjetësh nga kjo zonë. Të gjithë këtyre burrave e burreshave fisnikë që i përmenda dhe të tjerë që mund ti kemë harruar, dhe pa tjetër që kam harruar e që përsëri u kërkoj të falur edhe në se kanë ndërruar jetë, ju falem me shëndet emër për emër në tërë fshatrat e Temal-Dushmanit apo kudo që të jenë shpërndarë nëpër botë. Zanin e mirë ua dëgjofsha gjithmonë. Për jetë me ju.

RUZHDI PODA,

Ish mësues dhe Ish mësues dhe drejtor shkolle, në Temal-Dushman

SHOQATA AIDHETARE "DUKAGJINI" ZGJOI HISTORINË E KESAJ ZONE

**- MESAZHE ME RASTIN E
DEKORIMIT ME URDHËRIN
"NDERI I KOMBIT"
DUKAGJINIT -**

DUKAGJINI ZEMËR KU VALON GJAKU I KULLUAR SHQIPTARE!

Prele Milani, historian, poet dhe publicist

Dukagjini një emër shekullor, i cili dha historisë gjak, mirësi e virtyte të nektarta iliro-arbërore. I pozicionuar gjeografikisht në masivin qendror të Alpeve, të cilat ua morën të gjitha maleve të Shqipërisë, madhështinë, ashpërsinë, kompaktësinë, përthyer vertikalisht me lugina të thella, grykë përpirës, qëndisur me gjelbërim pyjesh e livadhesh të mëndafshita, rrethuar nga kordonë gjigante lidhur me qafa të rrezikshme, të cilat në unison formojnë skenën më poetike dhe frymëzuese të natyrës së egër shqiptare.

Aty, në çatinë më veriore të bjeshkëve tona gjendet gjymtyra organike më me karakteristike e Shqipërisë e artikuluar udobisht nga studiuesit si trajta shoqërore partikulare e fisit. Bash mbi masivin karbonatik të Jezercës është gdhendur emri Dukagjin si një nga krahinat më interesante në pikëpamjen historike, ndoshta më shembullorja në pikëpamjen etnografike, e gjithmonë kënduar si krahinë e lirisë e gjakut dhe nderës. Me Datën 23 mars 2016 ne ora 18-të, Dukagjini ndera e Shqipërisë u dekorua nga Kryetari i shtetit me medaljen e late "NDERI I KOMBIT".

Një urate e vonuar, por e dëlirë dhe merituar sa vete drita e diellit! Një vlerësim që erdhi me adetet më të veçanta që ka protokollin më i lartë i shtetit. Presidenti nuk kreu vetëm një veprim rutine protokollare, por përmes një ligjërate të drejtpërdrejtë, objektive, me një stil elegant tjerrur me tharje tipike rilindëse, evokoi, bëri autokritike dhe falënderoi Dukagjinin tone nga balli i oxhakut i odes presidenciale. Dekorata "Nderi i Kombit" erdhi e veshur me një aureolë historike, për ato male qiell gërvishtëse, strehe e fatosave kryengritës te pa shkelura kurrë nga as një çizme e huaj. Kjo dekorate e stiluar sot është karta e identitetit e Dukagjinin, të Lekes që Zot e shqipe pati ëndrën shekullore të jetës, i cili 500 vjet veç për atë ëndërr jetoj i ndryrë si anxa në zguer, pa bese pa ndore, duke hape llogore, lidhe plage e kënduar kënge kushtrimi me pushke në brez dhe parmendën në ugare.

"Nderi i Kombit" është një Medaljon i Artë në parzmoren atyre amazonave malësore të hijshme si yjet që kane vallëzuar përjetësisht me shqiptet, përkunden djepet duke rritë në xhubletë lirinë e ruajtur të pastër, genin e racës sonë të vjetër. Kjo dekorate është një epitaf i shenjtë për shpirtin luftëtarë të atyre maleve dhe mbi të gjitha për ata qindra e qindra kerrça bjeshkësh që bane vdekjen si me le për liri e demokraci, lule e trimërisë dhe burrisë shqiptare. Kjo dekorate është një mirënjohje historike për aromën e bukës së mrumë më e begata e magjeve ilire, e shtruar bujarisht në tërvesen më bujare të shqipeve. "Nderi i Kombit" është një xhevahir i munguar në xhamadanat fije artë, të çakçirëbardhëve të maleve tona, të cilëve, u shkëlqej në kuvend

urtia, u vetëqeverisën me kanunin e vet, folën me gjuhën e tyre shpate, kryefjalën e gegnishtes mbretërore, të pa ndikuar nga romanizmat, turqizmat as sllavizmat.

"Nderi i Kombit" për ty Dukagjin është një pip qelibari me filegrame sermi në buzën e rapsodëve të atyre viseve ku vringëllon lahuta dhe këngëtarët më autentik të marsheve epike arbërore, që nxjerrin mjalhtë për goje. Kjo medalje është një ikone re në paritat e atyre kullave të moçme, ku fjala e nderit u

shëndrrua në visare, me të cilën besatarët e kësaj toke sfiduan legjendat. Kjo medalje vjen si një vegim hyjnor, që rrezaton plot shkëlqim mbi kryqat e pa thyer mbi varre, vjen si shëlbim për atë qëndrese lapidare të martirëve të Kishës sonë Martire, ku nga 38 martiret e bekuar nga Papa, 8 ishin shqipe Dukagjini.

Dukagjini ky trëndafil gjigand me petla malesh, zemër ku valon një gjak i kulluar shqiptare dhe rreh poezia dhe proza e kristalte e Koliqit, Camajt, Reshpes, Benardin Palajt, Mark Krasniqit, Ndoc Papekes, Lazer Stanit, Ledja Dushit, Lazer Kodres e të tjerë; Dukagjin kopshte i bekuar artistësh dhe sportistësh me përmasa sa vete kreshtat argjendta, emrat e të cilëve kanë me u përmende për gjate mot në urimet dhe bekimet e visareve të artit dhe sportit shqiptare!

Njeztre marsi 2017 ishte një buqete e trefishtë për Dukagjinin, me urdhrin "Nderi i Kombit" u vlerësua Profesor Kolë Prele, një nga bijtë më të shkëlqyer të Dukagjinin. Ai nuk ka qenë veç i Dukagjinin apo i Shkodrës, por i gjithë Shqipërisë. Kjo dekorate është një memoriali pasi akoma sot patrioti, mendimtari, demokrati dhe fatosi i parlamentarizmit nuk ka një varrë në atdheun e tij, për të cilin luftoi me penë për t'i ndriçuar shikimin, me pushkë për t'i mbrojtur independencën dhe me kushtrimin që buronte nga gjoksi i tij djaloshar për lirinë dhe demokracinë e shumëëshiruar perëndimore. Kjo dekorate është një lule gjaku për lotin e pa thare të një nëne, e cila kur mësoi fatin tragjik të djalit të saj, humbi shikimin nga lotët e derdhur va, për derën e mbydhur me ferre. Kjo dekorate akorduar Profesor Kole Preles, është një apel për deputetet e sotëm të Shqipërisë të shvishen nga mëkate dhe sherrat e pa fund dhe ta duam Shqipërinë dhe demokracinë siç e deshë Profesor Kole Prele, se vetëm kështu mund realizohet ëndrra Evropiane e Shqipërisë.

Frederik Rreshpja urdhri "MJESHTER I MADH" e kishte skalitur në poezinë tij brilante, që kur ishte i ri dhe i shkurtuar krahet. Rreshpja ka provuar skllavërinë, prandaj e donte dhe e çmonte aq shumë lirinë. Rreshpja ka provuar vetminë, prandaj zemra i digjte flake nga dashuria. Ai i fluturuar drejt lartësive, prandaj e di sa e dhimbëshme është të zvarritesh. Rreshpja ishte liriku i pahijshëm i tokës, zog i qiellit, i lire dhe skandal që se meritoni.

Të lumtë dora President! Këto tre vlerësime plotësojnë mëse miri njëri – tjetrin. Ju betë më së miri detyrën, të cilën nuk e bën para - ardhësit tuaj, për 100 vjet!

Erisa Baxheri

Respekt për Dukagjinin dhe ndershëm! Kjo është një arritje e madhe për Dukagjinin e ndershëm! Nuk duhet të mburreni nga kjo, por të reflektohet për të trashëguar

vlerat dhe të bëhemi pjesë integrale në botën e qytetëruar. Një respekt të veçantë, për Drejtuesin e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", z. Ndue Sanaj

Me së fundmi më vjen jashtëzakonisht mirë, që legjenda e poezisë të Evropës Lindore, Frederik Rreshpja u vlerësua dhe u nderua me urdhrin "Mjeshtër i Madh". Por, është një turp për ketë 25 vjeçar, që asnjë njeri nuk u kujtua, për ketë legjende të poezisë! Frederik Rreshpja nuk është vetëm i Dukagjinin, se ai i përket poezisë botërore e kryesisht të Evropës Lindore. Unë kam pas fatin që në Tallin të Estonisë dhe në shume vende Baltike, edhe në Nice të Frances, edhe në Stokholm të Suedisë, në Prag të Çekisë, në Krakov të Polonisë, në Sevilla të Spanjës, në Tokio të Japonisë të recitoj poezinë e tij! Shumë të huaj më thoshnin, një qytet i tërë duhet të mbaj emrin, Frederik Rreshpja. Më vjen keq, por figura të tjera, aty nuk krahasohen me Frederik Rreshpen.

Unë do ngelem deri në vdekje, Rreshpjane!

FTESË PËR REFLEKTIM DHE PËRGJEGJËSI!

Lazer Stani, shkrimtar

Dukagjini "Nderi i kombit" është praniam, njohje dhe vlerësim i kontributit të dukagjinave në histori, i kontributit të tyre në luftat për liri, njohje dhe praniam i sakrificave dhe përpjekjeve të tyre për ruajtjen e gjuhës, besimit dhe identitetit kombëtar, të vlerave më të spikatura që përcaktojnë qenien tone si shqiptar. Por edhe njohje e praniam i vlerave të njerëzve të tij më të shquar, sepse një bashkësi matet me ngjarjet e njerëzve të tij të shquar. Historia dhe personalitetet e shquar, tashmë të njohur e të vlerësuar, na bëjnë të ndihemi krenar, por ndërkaq për secilin dukagjin, ky vlerësim është edhe njëftesë për reflektim, një ftesë për më shumë mund e sakrificë për një të ardhme më të mirë.

Dua të falënderoj me këtë rast Shoqatën Atdhetare "Dukagjini", një nga shoqatat më aktive në trojet shqiptare, që ka një kontribut të veçantë për frimin dhe mirëkuptimin në bashkësi, por edhe në njohjen dhe vlerësimin e Historisë së Dukagjinin, të vlerave që ka krijuar kjo zone, por dhe në vlerësimin e emrave të shquar të dukagjinave. Pa këmbënguljen, punën dhe investimin e kësaj shoqate sot nuk do ta kishte titullin "Nderi i Kombit" Dukagjini dhe as personalitetet e tillë si Mehmet Shpendi, Martin Camaj, Lin Delija. Kol Prele, apo Frederik Rreshpja "Mjeshtër i madh", poezia e të cilit është si kumbimi i kabanës së varur mbi portën e shpirtit të pikëlluar njerëzor.

Tashmë, secili dukagjin, ka më shumë përgjegjësi, siç kanë përgjegjësi bijtë e fmailjeve fisnike për emrin e Derës së Madhe dhe lavdinë e të parëve.

Ndoc Sukaj, New York 26 Mars 2017

I nderuar Ndue Sanaj Dukagjini, është fat tek unë, nuk është zgjedhje. Unë pata fatin e madh që kur hapa sytë, më quajtën dukagjin. Dukagjini farkëtoj tek unë, Ndershmërinë, Dashurinë, Punën, Devotshmërinë, por mbi të gjitha më mësoj, që kalliri i plot e mban kokën ulur, që të shohë rrugën të ecë e jo të shkeli, më mësoj që edhe në qofte se rrezohem të

ngrihem me dinjitet. Dhe ky je ti Dukagjini im. Më vjen shume e rende që të lame pas o vend Lindja ime, dhe largësia prej teje fizikisht na bën të vuajmë. Unë dhe familja ime personalisht falënderojmë të gjithë heronjtë, intelektualet, dhe të gjithë popullin e dashur të Dukagjinin, të cilët kontribuuan në shekuj për kombin tonë. Në veçanti falënderoj Shoqatën Atdhetare "Dukagjini", për punën e saj të pa lodhur që beri të mundur ketë eveniment që vjen një here në jete dhe vlerëson me titullin "Nderi i Kombit" ketë popull të mrekullishëm. Më shume respekt falënderoj Presidentin, Bujar Nishani për nderimin që i beri popullit fisnik të Dukagjinin.

Gjergj Perluca

Nderi i merituar që i bëhët Dukagjinin, duke e akorduar titullin "Nderi i Kombit" nga presidenti i republikës është një akt i mirëpritur nga të gjithë, por kryesisht për ata që janë te vetdijshëm për historinë e popullit tonë.

Dukagjini dhe Malësia e Madhe janë dy krahina e para shqiptare dhe të vetme në territorin shqiptar, që nisën kryengritjen e vitit 1911 kundër pushtuesit osman, që i ka shkaktuar dëme të jashtëzakonshme popullit shqiptar. Do të mjaftonte vetëm ky akt i lartë patriotik i kësaj krahine për t'i akorduar asaj titullin "Nderi i Kombit".

Unë mendoj se shteti shqiptar duhet ta kishte nderuar kontributin Dukagjinin, duke i ngritur një monument udhëheqesi të kësaj kryengritje, patriotit Mehmet Shpendi, detyrë të cilën e ka përmushur populli i kësaj krahine.

Unë kam bindjen solide për vlerat e mëdha që ka sjellur Dukagjini për gjuhën shqipe, duke e pasuruar si asnjë krahinë tjetër leksikon e saj. Dukagjini ka dhënë kontribute të rëndësishme për kulturën dhe sportin, mëgjithse ai ka qenë i marginalizuar gjithë kohën, edhe në shtetin shqiptar.

Unë besoj, sepse e dëshroj, që ky akt, akordimi i titulli "Nderi i Kombit", do të shërbejë edhe për hapjen e një kapitulli të ri në librin tonë të historisë të përbashkët, një kapitull të pranimit të ndërsjellët, të respektit, të mirëkuptimit dhe të vlerësimit objektiv. Vetëm kjo mundëson bashkimin e talenteve dhe të energjive, pa të cilin nuk mund të ketë demokraci të mirëfilltë.

Do të donja që në këtë kontekst të sjelli këtu një maksimum europiane, shumë e komentuar dhe e cituar në Europë, e cila ka këtë përmbajtje: "Edhe në qoftë se shteti funksionon perfekt si shtet i së drejtës, ai nuk është ende demokratik, në qoftë se tek ai nuk rritën sëbashku, ato që i përkasin së tërës". Kjo maksimum apelon për rritjen e të gjithëve, pavarësisht nga perkatesia krahinore, fetare, apo prejardhja, gjë që u garanton atyre natyrshëm të jenë kontribues në të gjitha vendim-marrjet shtetërore.

Unë mendoj, se shteti dhe politika shqiptare duhet të demonstrojnë se janë të bindur për deficitet e krijuara, për eliminimin e të cilave apelon kjo maksimum, dhe të angazhohet për të përbushur kërkesën e saj, duke kontribuar kështu pakonkurueshëm për demokracinë shqiptare.

Me rastin e akordimit të kësaj dekorate unë dëshroj t'i dërgoj të gjithë dukagjinave urimet e mija më të mira, më të përzemërta dhe të sinqerta."

Prof. Dr. Vuksan Kola

Teksa po prisja në heshtje dhe jo pa emocion për fillimin e ceremonisë së dekorimeve, në një mjedis përfaqësuesish nga krahina të ndryshme dukagjinase, brenda sallës së veprimtarive të Presidencës së Shqipërisë, meditim më çoi disa vite më pare, kur sa po isha vënë në dijeni të formimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Ishte një lajm mjaft i mirë, që më gëzoi shumë. Menjëherë më erdhi në mënde dhe reagimi im për këtë ngjarje në një intervistë të më vonshme, dhënë gazetës "Dukagjini" (Nr. 41, Prill 2007), në të cilën thuhej: "Kishte ardhur koha që edhe Dukagjini, si vendlindja e shumë atdhetarëve, artistëve, intelektualëve, mësuesve dhe e luftëtarëve trima, të ngrihet mbi mentalitetin e kohës e t'u fliste të tjerëve me gjuhën e vet, t'u tregonte atyre vlerat më të mira, traditat dhe zakonet, gjithë bukurinë e shpirtit të tij të paepur". Dhe më poshtë vazhdoja: "Botimi i gazetës "Dukagjini" ishte një ndërmarrje e vështirë, por e domosdoshme për dokumentimin e vlerave, traditave dhe zakoneve më të mira të kësaj treve, për publikimin me vërtetësi të historisë shumë shekullore të popullit patriot, trim e lirisdashës të kësaj zone e të figurave më të shquara të saj. Ajo është tribuna e mendimit të lirë, zëdhënëse e zjarrit e një zone të lënë në harresë në të kaluarën e që sot i duhet të nxitojë shumë për të kompensuar kohën e humbur".

Ndërkaj hyrja në salle e Presidentit të Republikës dhe fillimi i ceremonisë e ndërpreu meditimim tim. Ndërsa ndiqja me një frymë vlerësimet e merituar për Zonën e Dukagjinit, si edhe për dy prej bijve të saj më në zë, Prof. Kolë Prela e poeti Frederik Rreshpja, dhe marrjen në dorëzim të dekoratës së lartë "Nderi i Kombit" për Dukagjinin nga Z. Ndue Sanaj, kryetar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", u binda plotësisht se një prej faktorëve më të rëndësishëm kontribuues në marrjen e saj ishte puna e palodhur e Kryesisë drejtues të kësaj shoqate, sidomos e kryetarit të saj, dhe e stafit të Gazetës "Dukagjini", e cila në 160 numrat e saj evidentoi vlerat dhe kontributet kombëtare më të mira të kësaj treve shekullore. Kambanat kishin filluar të binin fort për t'u dëgjuar nga të tjerët. Tingujt e tyre u dëgjuan shumë larg, ndaj filluan të lëvizin ingranazhet e strukturave më të larta të shtetit. Dhe sot çdo dukagjinase, kudo që të ketë ngritur çerdhën e vet, ka të drejtën e patjetërsueshme të krenohet me vendlindjet e tij, ta ketë për nder të pohojë me plot gojën se është prej Dukagjinit.

Prelë Shytani

Përdetova emocione të papara gjatë ceremonisë së dhënies nga Presidenti i Republikës, Dukagjinit urdhrin "Nderi i Kombit". Ky urdhër i shton krenarinë çdo dukagjinasi, kudo që ai ndodhet, për vendlindjen e tij apo të parëve të tij. Shkulja nga pluhuri i harresës dhe vlerësimi që meritojnë i Dukagjinit dhe bijve dhe bijave të tij, është meritë e të gjithë dukagjinaseve ndër breza, por në veçanti e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" e veçanërisht e kryetarit të saj z. Ndue Sanaj, sepse që në formimin e saj prioritet kemi pasur evidentimin dhe promovimin e vlerave më të mira njerëzore, historike, natyrore, shoqërore e kulturore të Dukagjinit. Na mbetet shumë për të bërë në të ardhmen për nxjerrjen në pah e dhënë vlerësimin që meritojnë shumë figurave dukagjinase, të cilët deri tani kanë mbetur shumë në hije. Duhet të kemi detyrë primare për edukimin e dukagjinaseve të rinj me dashurinë për Dukagjinin, të cilët jo vetëm mos ta mohojnë se nga e kanë origjinën, por të kthehen në kontributor me mundësitë që do të kenë në përmirësimin e infrastrukturës dhe jetës atje. Kemi mjaft për të bërë në drejtim të përmirësimit të imazhit tonë, duke gërshtuar vetitë e virtytet më të mira të mbartura, që i qëndrojnë kohës, me

edukatën qytetare, në mënyrë që të përshpejtojmë integrimin në jetën urbane dhe ta meritojmë vlerësimin që na u dha.

Diana Bungu, studente

Ndjesi dhe kënaqësi e pa përshkueshme. Ishte një nder dhe privilegj që, arrita të jem pjesë e kësaj ceremonie. Për mua ishte dhe një moment i veçantë, që në këtë ceremoni të vlerësimi e të dekorimit të zonës së Dukagjinit dhe të dy figurave shumë dimensionale e përfaqësuese, të Profesor Kole Prela e poeti Frederik Rreshpja. Në këtë ceremoni të veçantë takova disa persona të veçantë që do të mbeten gjatë në kujtesën time, profesor doktor Vuksan Kola, kolonel Petrit Cuni dhe motrat Enkelejda e Edmira Sanaj, të cilat kishin ardhur nga Milano, enkas për të qenë pjesë e kësaj ceremonie, që na beri me krah të gjithë të pranishmit, kur u dorëzua urdhri "Nderi i Kombit" për Dukagjinin, dhe duhet të bej me krah çdo dukagjinase e dukagjinase kudo ndodhur.

Gjovalin Shyti, N/ kolonel në pension, Asti - Itali

Gëzuar festën, urdhrin "NDERI I KOMBIT"! Është nga evenimentet më të rëndësishme për zonën tonë të dashur, Dukagjini i mirë!

I mirë, i bukur, me një trashëgimi të pasur Patriotike, që në shekuj nuk reshti së luftuar për të ruajtur identitetin e tij nga çdo pushtues, që në kohët e hershme e deri në çlirimin e Atdheut tonë të dashur. Ishin bijtë e bijat e kësaj zone, që nuk lejuan ti nështrohët për asnjë çast pushtuesit shekullor osman, luftuan kundër serbeve e malazezeve.

Vërtete zona e jonë nuk është e pasur, terreni i thyer e nuk të jep shumë mundësi për një zhvillim të kënaqësishëm, por shpirti i malësorëve tanë ka qenë, është dhe do të mbetet i madh. Bujaria, mikpritja, besnikëria janë karakteristikat më të çmuara të kësaj zone.

Ketë vlerësim, kjo zonë e meritonte me kohë, por puna e berë nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini" ka qenë e jashtëzakonshme. Mirënjohje për jete kësaj shoqate, burrave e grave, të rinjve e të rejave që punuan gjithë këto vite për të evidentuar e pasqyruar me fakte meritat e vlerat e Dukagjinit në historinë e tij.

Respekt të veçantë për kryesinë e Shoqatës dhe bashkëpunëtorëve të tyre, që me gjithë problemet e pengesat në rrugën e tyre, nuk u ndalen, por ecën përpara me objektiva të qarta. Rezultati flet vete. Ngritja e monumentit të atdhetarit Mehmet Shpendit dhe e albanologut Martin Camaj, përgatitja e zhvillimi i tetë konferencave shkencore, promovimi i 67 librave, nxjerrja e 160 numra të gazetës "Dukagjini", e të tjera e të tjera, dhe së fundmi arritja e dekorimit të zonës së Dukagjinit, me urdhrin e lartë "Nderi i Kombit", janë vlerësimet më të bukura, më të merituar që i bëhen Dukagjinit tonë të dashur. Koha na bëri të jetojmë larg fizikisht, por mendjen e zemrën e kemi aty, në zonën tonë, me ju e me të gjithë dukagjinase kudo që jeni.

Lajmi mbi vlerësimin e zonës, na ka gëzuar pa mase, na ka shtuar besimin, që vetëm të bashkuar mundet të ecim përpara, mundet të rrisim vlerat tona duke u treguar shembullor kudo që jetojmë e punojmë. Mirënjohje për ju të nderuar motra e vëllezër për punën e jashtëzakonshme që betë në këto vite!

Popullit i Dukagjinit do ju nderoj tanë jetën për përkushtimin tuaj!

Respekt e përlujtje për punën tuaj!

Gëzuar vlerësimin, urdhrin "Nderi i Kombit", Dukagjini ynë!

Ndue Ftioni, biznesmen në Miçigan, SHBA

Ndue Sanaj e gëzofshim së bashku ketë emër të madhe, që Shoqata Atdhetare "Dukagjini", me kryesinë e saj, me aktivistët e saj nga Pulti, Shala, Shoshi, Temali e Shllaku po i ktheni Dukagjinit origjinën. Turqia na solli

ato q ena solli dhe nuk është vendi ti bëjmë analize, por Zogu na plaçkiti dhe na vrau, Partia e Punës na burgosi e na persekutoi. Partia Socialiste dhe partia Demokratike e te tjera na mashtruan, na bane me i kthye shpinën vendit tone dhe duke mos i dhanë asnjë fare vlere Dukagjinit. Ndërsa e vetmia strukture shoqërore apo politik apo shtetëror është Shoqata Atdhetare "Dukagjini", që punoi me aq përkushtim në mënyre vullnetare, duke jua rrite vlerat burrave e grave të Dukagjinit, të pushkës dhe të pendës, të artit dhe kulturës, që arriti deri ne atë nivel, ku Presidenti i Republikës së Shqipërisë ju akordoi urdhrin e lartë "Nderi i Kombit". Dukagjini është një vlere e madhe historike për Shqipërinë dhe do të mbetet e tillë.

Arritjet tuaja janë dhe do të mbesin historike dhe unë, në emrin tim personal dhe të grupit drejtues të TV të bashkësisë shqiptare, këtu në Miçigan ju uroj për zemërsisht për kontributet e pashtershme që ka bere kjo Shoqate për Dukagjinin. Vetëm në saje të kësaj Shoqate, Dukagjini mori emrin e madhe "Nderi i Kombit".

Dukagjini, e mbajt me ndere, urdhrin e lartë "Nderi i Kombit"! Dukagjinasi kudo ndodhen e ndjenë veten më krenar.

Domi Zabelaj

Ju falënderoj për zemërsisht të gjithë dukagjinaseve dhe shoqatën. Ky është vlerësim dhe krenari që Dukagjini ka meritën në shekuj me tradita dhe zakone që bota e qytetëruar ja kishte dhe ja ka zili që kurrë ata s'pranuan pushtimin dhe ruajtën me krenari të gjitha cilësitë fisnike, fetare e morale mes dallgësh dhe pushtimesh që kaloj kombe ynë. Krenari shqiptare, por duhet te them, se duhet ta duam shumë e më shumë njeri - tjetrin!

Krenari!

Rifat Ymeri, gazetar në TV kopliku

Urime gjithë trevës së Dukagjinit për urdhrin e lartë "Nderi i Kombit". Një vlerësim i vonuar ndoshta, pasi Dukagjini është njëra nder trevat më patriotike, me atdhetare dhe që ka shkruar një faqe të lavdishme në historinë tonë kombëtare. Një përshëndetje e veçantë për Shoqatën Atdhetare "Dukagjini" dhe Presidentin, Bujar Nishani.

Një vlerësim i merituar për Dukagjinin nder shekuj. Të e gjithë ndjehemi krenar për Dukagjinin dhe bijtë e bijat e saj nder vite!

Krenari!

Engjell Çeka

Mendoj se vlerësimin, me urdhrin "Nderi i Kombit", për treven e Dukagjinit asht shume i drejte, mbase duhej dhe më përpara, por Zoti vonon, kurre nuk harron. Ky vlerësim mbush me krenari të ligjeshme të gjithë banoret e Dukagjinit. Treve historike me personalitet të shquara me fusha të ndryshme të jetes. Uroj dhe pershendes të gjithë banoret e Dukagjinit. Kjo më takon në një fare mase dhe familjes Çeka (Summa).

Shendet dhe gjithë të mirat! Urime dhe ju si kryetar i Shoqates Atdhetare "Dukagjini", me grupin tuaj drejtues!

Kolonel Petrit Çuni, Shefi i Shtabit të Forcave Tokesore, të FASH

E kush nuk do ndihej krenarë në momente të tilla, në ceremoni nderi të tilla.

Në 33 vite në uniformë, nga këto plot 25 vite, në karriere ushtarake kam pasur fatin të marr pjesë në shumë e shumë ceremoni nderimi, dekorimi, gradimi e mirënjohje e të tjera, të gjitha kanë te veçantën e tyre, lëne mbresat e tyre dhe natyrisht kane dhe jehonën dhe shkëlqimin e tyre.

Mund të shkëpus një numër të konsiderueshëm ceremonisë e eventesh të cilat kane lenë mbresa e gjurme tek unë e madje lista e tyre do ishte e gjate dhe brilante.

Por, për hire të së vërtetës më duhet të po-

hoj, që një nder ato CEREMONI, që ka lenë një ndjesi e emocion krejt të veçantë, ishte ceremonia e datës 23 Mars 2017 e zhvilluar në mjediset e Presidencës, ku Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Bujar Nishani dekretoj urdhrin e lartë "Nderi i Kombit" trevës së Dukagjinit si dhe dy personaliteteve të spikatura të kësaj treve.

Kisha nderin dhe privilegjin që si pjesëtarë i bashkësisë Dukagjinase, Anëtar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" (Mbajtës i titullit "Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini"), të jem i ftuar në këtë event madhështore, ku që në krye të herës dua të përgëzoj e falënderoj të gjitha ata që punuan për përgatitjen e kësaj ngjarje nderimi e vlerësimi të jashtëzakonshëm (Kryetarin e Shoqatës dhe mikun tim Kolonel ne pension, Ndue SANAJ), Kryesinë e shoqatës, autoritetet e pushtetit vendore dhe gjithë ata që e bene të mundur kurorëzimin e këtij vlerësimi të munguar për personalitete të kësaj treve, por mi të gjitha për Trevën e Dukagjinit, vendlindjen tone, tashme dhe zyrtarisht "Nderi i Kombit".

Çfarë mund të veçoj më pare? ... Ishin të shumta të veçantat e kësaj ceremonie!

Audienca e mrekullueshme e përberë nga personalitete e intelektual te të gjitha fushave, Miq e adhurues të trevës së Dukagjinit!

Veshjet tradicionale dhe Kostumografia magjepse e kësaj treve e përfaqësuar nga grup moshave të ndryshme si për të sjell në vëmendje kujtdo, se tradita vijon dhe etnografia e eposi i kësaj zone nuk vdes kurrë, por trashëgohet nder breza

Të gjitha këto të shoqëruar me një kolazh fantastik të zërave të mrekullueshëm të bilbilave të Dukagjinit, ku me tingujt e Lahutës e Çiftelisë sollën në këtë mbërëse madhështinë e atyre aneve, por dhe lartësuan simbolin e Kombit Shqiptare, Gjergj Kastriotin dhe Shenjtore Nene Tereza.

E kursesi nuk mund të le pa përmendur dhe fjalën e rastit të Presidentit të Republikës, i cili beri një vlerësim maksimal për historinë, vlerat, virtytet e kësaj treve, të cilat me të vërtetë e bëjnë këtë zonë "Nderi i Kombit".

E thënë në mënyre esenciale teksta mbaheshin fjalime, akordoheshin medalje, jehonte kënga e Lahuta e Çiftelia në kujtesën / memorien time në forme retrospektive kalonin, historitë e lexuara e të dëgjua nga Gjyshi, ngjarje e data që janë shkalitur në historinë e kësaj treve, luftëtare të veshur me Guna e Gozhup që u kishin hije më shume se yjet e gjeneralëve, burra të kuvendeve e të urtëve, intelektuale e klerikë të persekutuar në periudha të ndryshme të historisë tonë të dhimbshme, pa harruar intelektuale e personalitetet të kësaj zone, që sot kontribuojnë në shume fusha dhe që fatmirësisht janë të shumte dhe lartësojnë emrin e kësaj treve fisnike.

Ndaj me plot zemër u them: Faleminderit për pasurinë e emrin që na latë trashëgim!

Faleminderit që e lartësuar emrin e kësaj treve me veprën tuaj, me kontributin tuaj e në shumë e shumë raste me gjënë më të shtrenjete, me Jetën tuaj. Faleminderit e nderim për jete!

Faleminderit të gjithë brezave, që na mundësuan të krenohemi, duke na lanë pas një emër e histori që dhe Kombi e ka në pedestalin e tij më të lartë, NDERI I KOMBIT!

Faleminderit gjeneratave të sotme për mos harresën dhe për vazhdimësinë e këtij emri të madh, Dukagjin! Faleminderit!

Luigj Shyti, Sekretari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe Kryeredaktori i gazetës "Dukagjini"

Vlerësim i lartë që mbasi mund të ishte bere edhe më pare. Gjithsesi duhet vlerësuar përpjekja e madhe e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" për punën e madhe, të vendosur dhe të kujdesshme për arritjen e këtij vlerësimi, se pa nismën e saj nuk do të arrihej në këto momente ky vlerësim i

madh. Falënderim dhe respekt në këtë rast meriton edhe Kryetarja e Bashkisë Shkodër, zonja Voltana Ademi, e cila mbështeti fuqishëm Shoqatën tone. Nder dhe respekt për Dukagjinin "Nderi i Kombit", nder dhe respekt për Kole Prelen "Nderi i Kombit", nder dhe respekt për Frederik Reshpja "Mjeshtëri i Madh".

Nder dhe respekt për të gjithë paraardhësit tanë që vunë në themelet e zonës dhe Shqipërisë zëmrën dhe mendjen pa mëdyshje.

Faleminderit me respekt Presidentit të Republikës, zotit Bujar Nishani për këtë vlerësim të lartë! Nder dhe respekt për kryesinë e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" e palodhur për Dukagjinin!

Respekt për të gjithë ata që ndërmorën nismën, për të gjitha ata që e mbështetën dhe për të gjitha ata që e realizuan, këtë vlerësim. Dukagjini, me gjithë punën dhe përpjekjet e mëdha gjate gjithë historisë shumë shekullore, në shërbim të atdheut, nuk ka marrë një vlerësim të tillë. Ky vlerësim që ju bë Dukagjinit dhe bijve të tij, është nxitje shumë e rëndësishme për punën e madhe që na pret për tu integruar me sa më shumë dinjitet dhe kulture në jetën bashkëkohore. Përshëndetje dhe respekt për të gjithë ata që kanë punuar dhe punojnë me përkushtim për Dukagjinin dhe vlerat e tij të mira njerëzore, historike, kulturore e tradicionale, në shërbim të atdheut. Ky vlerësim na bën më krenar për vendlindjen tonë dhe njerëzit e mire të saj. Përshëndetje dhe urime për veprimtari të tjera si kjo!

Fetah Bakija, Prishtinë

E gëzofshim tanë dukagjinasi me që jame nga Gjakova, por me prejardhje nga Dukagjini. Mendoj, se më bjen hise dhe mua.

Gjergj Kodra

Respekt e mirënjohje për të gjithë ata që vlerësojnë e nderojnë Dukagjinin dhe bije dhe bijat e Dukagjinit në vite. Roli i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" ka qenë vendimtar për shumë gjera të mira në interes të kësaj bashkësie, prandaj të gjithë bashke ta mbështesim Shoqatën në të gjitha veprimtari të që organizon, duke kontribuar pasivisht.

Sokol Lpeja, Greqi

Vlerësimi për Dukagjinin e për bijtë e tij na gëzon pa mase të gjithëve. Urojmë suksese gjithnjë e më të mëdha shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Respekt për drejtuesit e saj.

Pjeter Vuksanaj

E kam përshëndetur dhe e përshëndes përsëri Shoqatën Atdhetare "Dukagjini". Jeni të vetmit si keni punuar me përkushtim për të ngritur vlerat e zonës sonë, të njerëzve me vlera të respektuara të kësaj treve. Ju përshëndes për këto arritje të mëdha për zonën tonë. Faleminderit edhe pushtetit lokal edhe Presidentit për këto dekorata si i akordoj për zonën tonë të vuajtur në shekuj edhe deri këto ditët tona. Zoti mos e lashte zonën tonë pa njerëz të nderuar e të mençur.

Prof. dr. Zef Gjeta

Bashkohem me gjithë zemër me mesazhet në lidhje me vlerësimet për Shoqatën Atdhetare "Dukagjini", sidomos me kryesinë e saj, që në vijimësi ka punuar pa u ndale, me ide të qarta dhe me objektivitet konkret në punën për evidentimin dhe popullarizimin e vlerave të zonës së Dukagjinit. Ju uroj dhe ju inkurajoj për punë të mira dhe arritje si keto. Nderim për të gjithë figurat e Dukagjinit që i kanë dhënë emrin e mire dhe kanë formuar profilin e kesaj zone.

Fran Piniqi, Bruksel

Mirënjohje e respekt për të gjithë ata që vlerësojnë Dukagjinin. Kjo dekoratë është shumë e mirëpritur. Falënderim të madh për Shoqatën Atdhetare "Dukagjini", për kon-

tributin e dhënë në promovimin e vlerave kulturore e historike të Dukagjinit.

Pjeter Vuksanaj

Nuk e kam lexua kund as nuk e kam dëgjua nga kush se kemi pasur një vlerësim kaq të madh, se sa dekoratën "Nderi i Kombit". Është një vlerësim, që do mbetet në shekuj. Ju lutem mos e vlerësoni as mos u ndikoni politikisht. Kjo është një arritje e madhe e jona e marrun me përkushtimin e vetëmohimin e njerëzve tanë në breza të vjetër e të ri. Me të këtuillë intelektualësh si Kol Prela ka ardhur koha të përfaqësohemi edhe një here në parlament.

Zef Bari, mesues

Shoqata Atdhetare Dukagjini është shndërruar në institucionin më të rëndësishëm, ku dëgjohet zëri i dukagjinaseve. Kryesia e saj përbëhet nga avokaten të përkushtuar dhe këmbëngulës, që vlerat e trevës tone, të bijve dhe bijave të saj, të vlerësohen, jo vetëm përmes gazetës të shoqatës, librave, simpoziumeve, konferencave, por të përjetohen në bronz dhe tani në flori. Prandaj duhet të gëzojmë, të krenohemi, por dhe të mobilizohemi, për vlerat e tjera të reja që në meritojmë.

Lulash Vatnikaj

Të evidentosh vlerat shekullore të një populli trim dhe fisnik është nder dhe merito, aq më tepër kur i ngre dhe i vendos në elitën e vlerave të kombit.

Kjo është merito e atyre intelektualëve të Dukagjinit, që prej shume vitesh vijojnë të mbajnë lart krenarinë e atyre viseve.

Ti shërbesh popullit tënd është nder dhe ti shërbesh falas është dy here nder.

Ky bashkim vullnetar shokësh e miqsh Shoqata atdhetare "Dukagjini" meriton respekt dhe mirënjohje nga çdo malësor i Veriut që mban gjalle dhe ngre lart vlerat historike dhe humane të popullit të vet.

Dedë Zhivani, N/ kolonel në rezervë

Kur lartësohet e nderohet zona e Dukagjinit, nderohen e lartësohen gjithë Malësitë e Veriut Shqiptare. Meqenëse e kam ndjekur nga afër veprimtarin e Shoqatës Atdhetare "DUKAGJINI" e kam thënë e shkruar disa here në këto vite, se është shoqata më aktive dhe rezultateve mbare shqiptare në këto vite të veprimtarisë së saj. Kryesia e kësaj shoqate me personalitete cilësore, shumë të motivuar e me unitet mendimi e veprimi dhe kryetarin e saj, ushtarakun në pension, Ndue Sanaj, personalitet me dije të gjithanshme, me horizont të gjere kulturor, me vullnet e këmbëngulje të radhe, me aftësi organizuese, drejtuese e përbashkuese të spikatura, ja kanë arritur të hulumtojnë, evidentojnë, shkruajnë e promovojnë vlerat me të mira, më të veçanta dhe me përgjithësuese të kësaj zone, si në planin historik, kulturor, të gjenezës e të traditës, gjë e cila e ka ndriçuar portretin e dukagjinasi të skalitur në këtë vend e pedestal nderi, ku ka arritur sot. Nuk është momenti e vendi për të shkruar gjate, por vlerësimi e respekt të veçante meritojnë të gjithë ata anëtarë të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "DUKAGJINI", të cilët janë përkushtuar maksimalisht në këto veprimtari e sidomos ata, të cilët janë marrë me punë hulumtuese, shkrime artikujsh e librash, të cilët me punën, vullnetin, synimet e arritjet e tyre të veçanta i kanë bere nder të përjetshëm gjithë kësaj zone. Nxjerrja e përmuajshme e gazetës "DUKAGJINI", realizimi i shume veprimtarive cilësore, promovimi i figurave të mëdha të Dukagjinit në shekuj, të cilët kanë kontribuar maksimalisht për kulturën e çështjen Kombëtare, lartësimi i tyre deri në ngritjen e monumenteve, vendosjen në vende nderi e promovimi dinjitoz, janë shembull për t'u marrë e vlerësuar edhe nga shoqatat e tjera simotra.

Gjithë kjo veprimtari në vite ka pasur edhe

kosto financiare, prandaj është rasti për të shprehur vlerësim, nder e respekt, për të gjithë ata e ato, që në këto vite të veprimtarisë të kësaj shoqate, kanë kontribuar nga ana financiare të domosdoshme, pa të cilat kane qene të pamundura këto arritje.

Shume Urime, Vlerësim, Nderimi e Respekt për te gjithë ato e ata, te cilët kane kontribuar për këto arritje deri ne këto nivele te zonës e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", e ne veçanti Kryesisë se saj, te cilët e zgjuan historinë e kësaj treve, e evidentuan, e ndriçuan dhe e ngritën ne pedestalin tone Kombëtar! E gëzofshi, në shekuj e brez pas brezi, ketë nderim e nivel të veçante, ku arritet me vlerat tuaja dukagjinase e përpjekjet e punën tuaj të veçante!

Dukate Bregu, mësuese

U ndjeva e emocionuar për prejardhjen time Dukagjinin, vendi i paraardhësve të mi, vendi i origjinës sime, i cili u nderua me Urdhrin me te larte "Nder i Kombit". Duke marre parasysh vetëm sakrificat e njerëzve të ndritur të kësaj treve për lufte e liri, për demokraci dhe për mbrojtjen nëpërmjet artit e kulturës të vlerave më të mira të një kombi, them se edhe pa e marrë këtë titull, dukagjinasi ndodheshin krenar kudo brenda e jashtë Shqipërisë për origjinën e tyre. Them, ky titull megjithëse i vonuar në kohe, ish një shpërblim i vogël i shtetit për atë krahinë, të harruar e të leme pas dore nga çdo politike, por me bukuri të virgjëra përrallore, ashtu siç tha edhe vete Presidenti, i cili me la pa fjale për njohjen aq të mire të vendit e origjinës sime.

Surpriza për mua te këtij evenimenti s' patën të sosur, kur sapo arritëm në Tiranë, nga Italia enkas për ketë ngjarje shume të rëndësishme kishin mbërritur po ato çaste edhe dy vajzat e mrekullueshme të Kryetarit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Enkelejda dhe Edmira, të cilat për të qenë pjese e grupit përfaqësues të zonës së Dukagjinit, kishin lenë gjitha punët e tyre në Itali (Milano) për të qene në krah të babait tyre, për ketë nisme dhe pune të madhe që ka bere gjate gjithë këtyre viteve. Sot ato u ndjenë krenare më shume se kurrë për sakrificat e një jete të tërë në shërbim të Atdheut dhe sot!

Si pjese aktive e kryesisë tash sa vite duhet falëndero veçanërisht gjithë kryesia dhe anëtarë e anëtare të saj për kontributin e mundin, por veçanërisht ai, i cili nuk ndalet para asnjë vështirësie për realizimin e projekteve të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", kryetari i saj z. Ndue Sanaj. Dua ti uroj jete të gjate e të lumtur për realizimin e projekteve të tjera në shërbim të vlerave të bashkësisë që përfaqëson.

Roza Pjetri, Radio Maria

Ka momente të shumta në jetën e njeriut që skalisin në librin e jetës së tij vlere, të cilat ta bëjnë jetën të lumtur. Për mua ishte dy herë fat të isha e pranishme në Presidencë si përfaqësues e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Hera e parë ishte vizita e parë që bëmë në Presidencë në shenjë falënderimi për Presidentin z. Bujar Nishani dhe kabinetit të tij në mbështetje të punës sonë për realizimit me sukses të dy monumenteve, të atdhetarit Mehmet Shpendit dhe te albanologut Martin Cama. Në këtë takim vëllazëror nga vetë Presidenti u dha mendimi për një takim të dytë. Kjo ishte një e papritur e madhe për të gjithë, e cila sollti me vete edhe të papritura gjurmëlënëse për të gjithë. Dita e Enjte e 23 Marsit 2017 do mbetet një ditë në librin e jetës time me një flet që do lexohet shpesh. Nderimi që Presidenti i bëri Dukagjinit dhe bijve dhe bijave të tij ishte në kohën e duhur. Shumë mund të thonë i vonuar, por çdo gjë na dhurohet prej Zotit në kohën e duhur, në vendin e duhur dhe nga persona të duhur. Ky nderim na u dhurua në Pranverë dhe kështu do mbetet gjithmonë jeta e Dukagjinaseve. Pranverë për vete dhe për Kombin. Ky nderim er-

dhi në atë kohë ky brenda pak minutash Dukagjinasi, në të gjitha kontinentet u njohën me këtë Nderim dhe nga zemra e tyre jehoj zëni ... «O SA MIRE ME KËNË DUKAGJINASI!». Faleminderit z. President dhe djemve të kabinetit të tij!

VLERËSIM PËR SHOQATËN "DUKAGJINI" ME RASTIN E DEKORIMIT ME TITULLIN "NDERI I KOMBIT"

Besnik Gjonbrati, Kolonel

Si vlonjat, lab njëkohësisht dhe si ishqytetar e ushtarak për shume vite i Shkodrës, por edhe Malësisë se Madhe, ndjem krenar për gjithçka shpirtërore dhe fizike që më lidh me Vlorën, krahinën e Labërisë, me Shkodrën dhe patjetër krahinën e Dukagjinit, si dy krahina të rëndësishme e me zë në Shqipëri, që sot secila përfaqësohet nga shoqata e saj atdhetare e kulturore "Labëria", tashmë "Nderi i Kombit" dhe "Dukagjini", që sapo iu dha nga Presidenti i Republikës po i njëjti titull "Nderi i Kombit" me motivacion pak a shumë të njëjtë "Për kontributin e dhënë në luftën për liri e demokraci...". Dy krahina që në shekuj i kanë dalë zot vendit, dy krahina që nga gjiri i tyre kanë lindur heronj e dëshmorë, të cilët kanë dhënë jetën për mbrojtjen e trojeve dhe çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj, dy krahina nga gjiri i së cilave kanë dalë personalitete të larta të politikës, diplomacisë, shkencës, artit e kulturës, ekonomisë, ushtrisë, sportit, dy krahina që kanë qenë dhe janë promotorë të lëvizjeve përparimtare e demokratike në vend në të gjitha kohërat. Ndjem krenar që me këto dy krahina më lidhin shumë gjëra të përbashkëta. Me rastin e dekorimit të krahinës së Dukagjinit me titullin "Nderi i Kombit", banorëve të kësaj krahine, Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe kryetarit të saj, zotit Ndue Sanaj, ju uroj: "E gëzofshi dhe e mbajtshi me nder këtë titull të madh "NDERI I KOMBIT".

Frasher Racaj, Sekretari i Përgjithshëm, i Shoqatës "Martin Dreshaj", Pejë

Dukagjini "Nderi i Kombit"!

I nderuari kryetar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" z. Ndue Sanaj, të nderuar Dukagjinasi, ju uroi në emrin tim dhe në emër të Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qender në Pejë me Rastin e Dekorimit nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani Zonen e Dukagjinit, me urdhrin "Nderi i Kombit". Presidenti Dekoroi edhe dy dukagjinasi, profesorin Kolë Prelen me urdherin "Nderi i Kombit", pas vdekjes, dhe poetin Fredrik Reshpja, pas vdekjes me urdherin "Mjeshtëri i Madh".

Dukagjini si zonë gjatë të gjitha periudhave të historisë ka dhënë një kontribut të çmuar për kombin tonë dhe është një minier thesari që na bënë krenar me diversitetin kulturor dhe ardhëtar që pasqyron traditën dhe qytetërimin tonë të mirëfilltet, me bujarin, mikpritjen dhe sakrificën në mbrojtjen e atdheut. Dukagjini është zona e sakrificës për mbijetesë dhe ruajtje të identitetit kombëtar nder breza. Dukagjini është zona e kryengritjes së madhe e djelmënisë shqiptare që nuk e pranoi nenshttrimin dhe armikun e priti dhe e përcielli me plumbë. Nderimin që i bëri presidenti Nishani zonës së Dukagjinit është më së merituar dhe ne si kombë e çmojmë lartë dekoratën "Nderi i Kombit" për vlerësimin e arritjeve të mëdha në të gjitha fushat e jetës që kaloi Dukagjini nëpër sfidat e mbijetesës dhe të arritjeve të mëdha. Me nderime të larta sekretari i Përgjithshëm i SH.V.K.M.M "Martin Dreshaj", në Pejë, Frashër Racaj


Lotajt e Shalës

«E ashpër, e vrazhdë, si populli i fuqishëm që e flet, por edhe plot shije e hijeshi, si frutat dhe lulet e malit ku flitet, gjuha shqipe – ndonëse e varfëruar nga një palëvrin shumë herë shekullor – është e aftë të shprehë, me një ndjenjë të mrekullueshme, nuancat, konceptimet më të holla e të mprehta të mendimit njerëzor». (Faik Konica. Albania 1, 1897)

Me datë 12 Mars 2017 në orën 10.00 në mjediset e Bar Resorant Tradita në Shkodër, Shoqata Atdhetare Dukagjini organizoi me sukses paraqitjen e librit «Lotajt e Shalës» të autorëve Zef Lulash Sokoli dhe Lulash Ndoc Gilaj.

Pas një punë të gjatë autorët sollën për lexuesin historinë e këtij fisi në të gjitha aspektet e jëtës së tij. Në fjalën e të pranishmëve ra në sy mirënjoha e thellë për punën e bërë nga autorët në fjalë. Ky libër u cilësua si një thesar i vyer i cili do i shërbej kohës dhe brezave që vinë, për njohjen e genit, historisë, bukurisë së natyrës, etnografisë, vlerave të fisit dhe

të bijëve dhe bijave që lindin e u rriten dhe e jetuan jetë, krenar për trashigimin që e ruajtën ndër shekuj. Është punuar shumë dhe mirë që libri të këtë të gjitha



parametrat e kërkuara për një libër të tillë. Edhe në këtë paraqitje Lotajt

shpalosën vlera që janë për tu pasur shembull nga të gjithë, ishin së bashku dhe të rrethuar nga miq e dashamirë, nuk kishte i parë dhe idytë, i vogël apo i madh, secili ndihej mirë në vendin e tij. Ambjenti, pra Bar Resorant Tradita, vlerë e paarritshme deri tani në Shqipëri e Veriut edhe pse në mesin e qytetit Shkodrës. Tëk ngjet



shkallët e tij të çon menjëherë në mesin e bjeshkëve dhe të vesh më të këunin

Dukagjinës. Vertet bukur dhe mire për cdo gjë që ne morem në këtë paraqitje libri. Fletët e tij do shfletohen cdo ditë dhe falenderimi për autorët që na e sollën do jetë gjithmonë.

Jo pa qëllim po e përmend në fund njërin nga autorët, Zef Lulash Sokolin ai është i sëmurë dhe nuk mund të them se nuk ishte i pranishëm. Ai po vuan sëmundjen në shtëpinë e tij por erdhi si gjithmonë në mesin tonë krenar dhe i fuqishëm. Kjo ashtë një dhuratë që Zoti ja ka dhuru Dukagjinës të jetë gjithmonë në vendin e duhur dhe në kohën e duhur dhe pse sëmundja e trupit na i lidhë këmbët por Shpirti nuk ndalet ai endet mbi bjeshkët tona, duke thanë se jeta është e bukur dhe nuk sosit kurrë. Ky është edhe mesazhi i këtij librit për të cilin nuk po ju flasim por po ju ftojme ta lexoni e ta rilexon.

Në përfundim një falenderim të madh për autorët, bashkëpunorët e tyre dhe të gjithë ata që kontribuan në realizimin e tij. Fasleminderit Lotajave që po vazhdojnë ta pasurojnë vetën, Dukagjini dhe Kombin me vlera që shkojnë ja përcollën e pa ja përcjellin njëri-tjetrit.

Roza Pjetri

PËR LIBRIN "LOTAJT E SHALËS" TË AUTOREVE ZEF SOKOLI DHE LULASH GILAJ

Në librin që po marrim në dorë ka shumë, shumë, dashuri. Autorët Zef Sokoli dhe Lulash Gila na kanë dhënë një studim shumë të kujdesshëm, me vlera shumë të mëdha për Lotajt e Shalës, për të gjithë zonën. Aty ka gjithë kujdesin e këtyre autorëve për vendlindjen e tyre, për zonën në të cilën bën pjesë ky fshat me emër të madh dhe të njohur gjerësisht, për pjesëmarrjen e tij në të gjithë veprimtarinë që është përfshirë Shala e Dukagjini, por, edhe sa herë ka pasur nevojë Atdheut. Lotajt e Shalës vinë në këtë libër në të gjithë gjerësinë dhe thellësinë e tyre, qyshë thellë në histori, më lëvizjet e tyre, me pjesëmarrjen e tyre në mënyrë aktive. Ky libër është studimi i parë dhe gjithpërfshirës për fshatin Lotaj.

Këta autorë janë të dashuruar me librin, duke kërkuar e lexuar. Libri dhe dashuria për të, të fisnikëron, të bën të njohësh e shijosh aromën e tokës nënë, të bën të njohësh realitetin, por miqësimi dhe shkrimi i librit është edhe një altar ku mund të rrefehesh. Pikërisht këtu, kemi një rrefim të zgjeruar për fshatin e tyre, me ndërgjegje, hapur dhe plotë respekt e dashuri për natyrën, punën, historinë, njerëzit e të gjitha moshave dhe kohëve, për shkollën dhe kulturën popullore, mënyrën e jetesës, etj. Libra si ky, dhe që kemi parë edhe më parë për fshatra të veçantë të Dukagjinit, janë gurë të fuqishëm dhe të çmuar në themelet dhe ndërtimin e historisë dhe kulturës së fshatit, krahinës dhe më gjerë, në njohjen dhe popullaritetin e vlerave të tyre.

Si rezultat i lëvizjeve të vrullshme demografike, popullsia e zonave rurale dhe veçanërisht ato malore janë radhuar ose janë boshatisur lagje apo fshatra të tërë përfundimisht.

Në shekuj këta banorë dhe këto zona kanë krijuar dhe ruajtur një material shumë të fuqishëm dhe të vyer gjuhësor por edhe të fushave të tjera që tregojnë kulturën dhe vjetërsinë e banimit në këto zona. Në këto

zona dhe këto male, gjuha, por edhe kultura materiale popullore e historike është ruajtur shumë, është ruajtur si një vlerë pothuaj hyjnore dhe kështu është transmetuar nga njëri brez në tjetrin. Këto vlera janë ruajtur, gjatë kohës, për të cilën kanë ndikuar edhe kushtet natyrore-fizike të relievit, largësisë nga zonat me popullsi më të madhe dhe të ndikuar nga lëvizjet e popullsisë, por edhe si rezultat i izolimit nga pushtuesit. Nga ana tjetër edhe vetë banorët kanë bërë një farë vetëizolimi për tu mbrojtur jo vetëm nga ndërhyrjet ushtarake, por edhe nga ndikimet në gjuhën e tyre, fenë, zakonet, traditat, ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëjetesës, etj. Këto kanë çuar në qëndrueshmërinë e asaj historie, të atyre fjalëve dhe shprehjeve shumë të goditura, për ti dhënë përgjigje gjithçkaje, përdorimin e fjalëve të thjeshta, të shkurtëra, apo shprehjen e kërkuar me pak fjalë, pra shkurt e sekt. Këto vlera shumë të rëndësishme është e domosdoshme që të ruhen në mënyrë më të mirë të mundshme.

Ruli i globalizimit vepron, pavarësisht nga dëshira jonë. Por më shumë goditet ajo pjesë që është më e pa përshkruar dhe e pa pasqyruar, me një fjalë, e pa studiuar dhe evidencuar. Në këtë gjendje, mbledhja, studimi i tyre, si dhe botimi i librave të tillë si ky që po marrim në dorë janë me shumë rëndësi për të sotmen dhe më shumë për të ardhmen, për brezat që vinë.

Libri "Lotajt e Shalës" është burim i rëndësishëm për të gjithë ata që duan të merren me studime gjuhësore, historike, etnografike, lëvizjen demografike të popullsisë, zhvillimin e arsimit dhe të kulturës, bashkëjetesën dhe marrëdhëniet shoqërore në zonat tona. Ky libër ka karakter studimor dhe enciklopedik për këtë fshat, por shërben edhe si një shembull i mirë edhe për të tjerët.

Autorët, krahas kërkimit të burimeve të shkruara janë mbështetur edhe në gojëdhëna të cilat kanë qenë të shumta dhe me shumë vlerë edhe për këtë libër.

Pasqyrohet me fanatizëm mesazhi i përpjekjeve për liri e përparim shoqëror, vendosmëria, besa, fisnikëria, dashuria për shoqi shoqin, dashuria e thellë për Atdheun. Vlerat e banorëve të Lotajve, të pasqyruara në këtë libër, janë mobilizuese, e bëjnë lexuesin dhe veçanërisht komunitetin e Lotajve dhe ata që ka lidhje më Lotajt, pavarësisht se ku banojnë, krenar, shtojnë energji pozitive.

Në faqet e këtij libri pasqyrohen me shumë saktësi veprimtarë e luftëtarë, të rënë në luftë kundër armiqtëve të vendit dhe për ndërtimin e tij. Aty gjenden të pasqyruara lidhjet e gjakut të Lotajve në Shalë por edhe të tjerëve që janë larguar prej shekujsh, si ata të Dajçit të Bregut të Bunës, Jubanit, Derrajve të Postripës, Malit të Zi, Dinoshës, etj. të kërkuara e hulumtuara me kujdes dhe këmbëngulje nga autorët.

Toponimet e mbledhura dhe të pasqyruara në këtë libër, lojërat popullore, por dhe pasqyrimi i momenteve të jetës së përditshme, janë sa të bukura, po aq të rëndësishme sepse flasin shumë edhe për historinë, etnografinë dhe kulturën popullore të fshatit, që në një farë mase janë edhe pasqyrim krahinor. Fjalët dhe frazeologjitë popullore të pasqyruara në këtë libër, jo vetëm që janë të veçanta e domethënëse, por edhe material për të punuar gjuhtarët.

Autorët kanë bërë kujdes që të mos sajojnë, por të qëndrojnë sa më afër realitetit. Kanë zhvilluar shumë konsultime me intelektual dhe njerëz të thjeshtë të Lotajve, por edhe më gjërë. Në këtë libër ka shumë për Lotajt, dhe të shkruara me zemër të hapur. Autorët kanë rreth 30 vjet që mbledhin materiale për këtë botim.

Libra si ky, sa më shumë kohë të kalojnë u rriten vlerat, bëhen më të kërkuar, nga ata për të cilët shkruhet aty, por, edhe nga studiuesit e fushave të ndryshme.

Ngrohja e librit me mbi 200 foto të kohëve të ndryshme, pavarësisht nga cilësia për shkak të teknologjisë, por edhe të kohës, dhe

vendosja e tyre sipas rendit alfabetik, është një zgjedhje shumë e zgjuar, pasi të gjitha ata që pasqyrohen aty janë më prejardhje të përbashkët, janë brenda llojit, ose kanë dhënë ndihmesë për Lotajt pavarësisht se ku ndodhen.

Në këtë libër kërkohet e shkruhet edhe për shtrirjen e arsimit dhe kulturës, higjienën dhe pastërtinë, mënyrën e jetesës, përhapjen e librit në fshat dhe familjet e Lotajve, gjejmë radhën e ujitjes së bimëve, radhën e bluarjes në mulli, kufizimet e fshatit Lotaj por edhe të zonave të tjera ku banorët të cilët janë me origjinë nga Lotajt, etj. Të gjitha këto janë risi në botimet e deritashme për krahinën e Dukagjinit. Autorët Zef Sokoli dhe Lulash Gila, me përpjekjet dhe këmbënguljen e tyre, me materialin që kanë mbledhur, bënë më të mirën e mundshme.

Për realizimin e këtij botimi ndihmoj e punoj me respekt e kujdes, mjaft të mirë edhe shtëpia botuese "Fjorentia", në Shkodër e cila meriton vlerësim shumë të merituar.

Ndjehem i vlerësuar që isha redaktor i këtij libri. Bëmë atë që mund të bënim duke bashkëpunuar me autorë shumë të përkushtuar e pasionant. Gjithsesi arritëm në botimin e tij dhe jam i bindur se bëmë një punë të mirë. Vlerësimi përfundimtar, pa tjetër, që është i lexuesit, por dua të theksoj mendimin tim se në secilën prej 325 faqeve të librit dhe rreth 62000 fjalët që shkruhen në të, ka vetëm dashurinë dhe respektin e autorëve për fshatin Lotaj dhe banorët e mrekullueshëm të tij. Ky libër është i vlefshëm për sot dhe mbështetje e fuqishme për brezat që do të vinë, përfshi edhe studiuesit.

Po përfitoj nga rasti që të bëj të ditur se bashkë me Zefin kemi pothuaj gati një studim mbi dinamikën e popullsisë së Dukagjinit pas vitit 1990, që besoj se së afërmi mund të dalë në qarkullim.

Autorëve ju uroj shëndet e jetë të gjatë dhe punë të tjera si kjo në të mirë të shoqërisë.

Luigj SHYTI

Tiranë - Zonja Camaj: Ë lumtur që u martova me shqiptar.

NJË UDHËTIM NJOHËS NË KRIJIMTARINË CAMAJT 25-VJETORI I VDEKJES SË MARTIN CAMAJT

Në një takim me gazetarët në shtëpinë botuese "Onufri", Erika Camaj e pyetur nga "Shqiptarja.com" se sa e perceptueshme është vepra e Martinit nga vetë ajo, kur e gjitha është shkruar për Shqipërinë dhe shqiptarët, është shprehur se e gëzon fakti që shumë personalitete shqiptare e vlerësojnë shkrimtarin, ndërsa për të ishte e natyrshme të kuptohej mirë, përderisa ajo ishte e lumtur dhe e vetëdijshme që u martua me një shqiptar.

"Kam dëgjuar se shumë personalitete shqiptare që e vlerësojnë Camajn. Kjo më gëzon. Unë e kam përjetuar veprën e tij me elementë të theksuar shqiptarë, sepse që kur u martova me të isha e lumtur dhe e vetëdijshme që po jetoja me një shqiptar", është shprehur Erika.

Ndërsa studiuesi i veprës së Camajt, Bardhyl Demiraj u shpreh në takimin e gazetarëve me Erika Camaj se "Është tragjedi e madhe që krijimtaria e tij që shkruhej shqip në Gjermani e për Shqipërinë nuk kishte komunikim me lexuesit shqiptar".

Erika Camaj ka ardhur nga Gjermania në Tiranë për të qenë pjesë e kujtimit të 25-vjetorit të ndarjes nga jeta të shkrimtarit shqiptar në një aktivitet të organizuar nga Shtëpia Botuese "Onufri" në bashkëpunim me Degën e Albanologjisë në Ludwig-Maximilians-Universität München.

Mbrëmja letrare që mbajti këtë të enjte, date 9 mars 2017, në Hotel "Tirana International", ku përveç bashkëshortes së Martin Camajt ishte edhe një nga organizatorët e mbrëmjes Hans Joachim Lanksch, përkthyesi i shquar i letërsisë shqipe në gjermanisht dhe bashkëpunëtori i ngushtë i Martin Camajt.

Në këtë mbrëmje u hodh më shumë dritë për jetën dhe veprën e Martin Camajt, e cila ende është në hije në vendin e tij. Është autor antologjik në letërsinë shqipe, por nuk përfshihet në këtë antologji. Për këtë çështje disa vite më parë Hans Joachim Lanksch ka shkruar se "Më 1996 në Tiranë u botue një pjesë e madhe e veprës së tij letrare në një botim të kujdesshëm e serioz. Megjithatë, botimi i pjesës së mirë të veprës letrare të Camajt duket se mbeti pa jehonë të fortë, ashtu si dhe botimet jo të shumta të përkthimeve në gjuhë të hueja.

Poezia e Martin Camajt nuk e pushtonte terrenin e antologjive ku, fjala vjen, vargjet e Ismail Kadaresë dhe Ali Podrimjes zënë shumë më shumë vend sesa vjershat e Martin Camajt. Në veprat linguistike vazhdoi heshtja për emnin e albanologut Camaj, me ndonjë përjashtim të rrallë siç është, bie fjala, "Dialektologjia" e Jorgji Gjinarit dhe Gjovalin Shkurtajt".

Ndërsa më tej Lanksch thekson arsyet e mënjanimit të këti autori të shquar "Gazetaria dhe publiku lexues ishin të mësues me ushqim letrar që kapërdihet më lehte dhe jo me poezi sikurse është

ajo e Camajt – apo e Zef Zorbës a Primo Shllakut – që thotë shumë sepse flet pak.

Gjuha e Martin Camajt mund të jetë një si pengesë tjetër në perceptimin e veprës së tij e cila nga shumëkush apostrofohet si ikonë e lashtë dhe e vyer, por njihet bukur pak...."

NJË UDHËTIM NJOHËS NË KRIJIMTARINË E MARTIN CAMAJ

Martin Camaj ndërroi jetë 25 vjet më parë në Mynhen të Gjermanisë. Për fat të keq si shumë autorë shqiptarë, të gjallë apo të vdekur, Martin Camaj edhe pse e kishte marrë atdheun me vete në zemër



njihej fare pak në Shqipëri. Madje as që i përmendej emri, ndërsa gëzonte nam të madh në Itali në Gjermani, në të gjallë.


Pas rënies së diktaturës u thyen muret e izolimit të Shqipërisë nga bota dhe veprat e Camajt të shkruara në mërgim iu kthyen lexuesit shqiptar. Pjesa më e madhe e tij është botuar nga "Onufri". Tashmë lexuesi shqiptar e njeh mirë veprimtarinë e shumanshme kulturore, artistike e shkencore të Martin Camajt, por veprës së tij, që mbush boshllëkun e historishkrimit të letërsisë moderne pas Migjenit në letërsinë shqipe ende nuk i është bërë një zëbërthim shterues.

Martin Camaj u largua nga Shqipëria në vitin 1948, duke marrë me vete mbresat dhe kujtimet e pashlyeshme të vendlindjes, rrënjët e atdheut të tij i thelloi në krijimtari, sa dhe vetë bashkëshortja e tij gjermane, Erika, një grua e ëmbël dhe e dashur, me profesion mjeke, u lidh shpirtërisht me Shqipërinë. Veprat e para të Camajt ku shfaqti talentin e veçantë të tij ishin "Një fyell ndër male", botuar në Prishtinë më 1953. Pas këtij vëllimi me poezi, Martin Camaj botoi "Kënga e vërrikut", më 1954 në Prishtinë; "Djella" (roman lirik bashkë me disa poezi - më 1958, në Romë); "Legjenda" (poezi, më 1964; "Lirika mes dy motesh" (poezi, botuar në Mynhen më 1967); "Rrathë"

1978; "Njeriu me vete e me të tjerë" 1978; "Dranja" (madrigal, më 1981); "Shkundullima" (pesë proza dhe një dramë, botuar po aty, më 1981; "Karpa" (roman, 1984), e të tjera.

Përveç këtyre veprave, Martin Camaj ka botuar mjaft shkrime kritike, ese e studime nëpër revista të ndryshme, si për shembull: "Zjarri", "Shejzat", "Albania", "Jeta e re", "Südost Forschungen", e të tjera. Vepra e Martin Camaj e sidomos poezia e tij njihet për plot motive, shëmbëlltira e tipare natyraliste nga malësitë e Shqipërisë Veriore, ku spikasin shprehitë e traditës shkodrane.

Martin Camaj edhe pse nuk u lidh dot me lexuesit shqiptarë për arsye të



diktaturës ka mbajtur lidhur urat me poetët më të mirë e të shquar të shqipes ku i kushton poezi edhe Ndre Mjedës.

Ai frymëzohet nga metrika magjike e Mjedës, por poezitë e tij janë më të kursyera në fjalë e të pasuara me imazhe e ngjyresa karakteristike të vargut.. Pas disa vitesh qëndrim në Gjermani në vitin 1957 Camaj u vendos në Romë, ku poezia e tij u ndikua nga rryma hermetike e poetit italian Ungareti, si dhe nga narrativa lirike e Mondales.

E megjithatë artin Camaj i ruajti veçoritë kombëtare, pa u zvetnuar nga ndikimet e huaja. Ndjenjat dhe mendimet që i gëlonin përbrenda, malli për tokën shqiptare, janë gjithmonë brenda metaforave hermetike të tij, shpesh me kode të drejtpërdrejta të miteve e legjendave që njihen vetëm në tokën e tij.

Në veprat e shkruara shqip të Martin Camajt zotëron një gegërishte veriore me shumë vlerë si kujtesë të dialektit të hershëm të pasura me lëvrime të reja gjuhësore.

Martin Camaj ka dhënë kontribut edhe në gjuhësi. Ai vlerësohet nga kritika dhe lexuesi si Mjeshtër i fjalës në prozë dhe në poezi. Por ende në shkollat e letërsisë shqipe nuk njihen përmasat e gjera të krijimtarisë së këtij shkrimtari si

romancier e dramaturg.

Roman i tij i jashtëzakonshëm "Rrathë" doli në dritë pas një pune 15-vjeçare të autorit. I habitshëm sesi ai nga larg pa e parë dhe prekur Shqipërinë ka depërtuar dhe ka zbërthyer dukuritë e jetës shqiptare.

Botuesi i veprës së plotë të Martin Camaj në Shqipëri, Bujar Hudhri pohon se ende studiues të letërsisë nuk e njohin mirë krijimtarinë e plotë të Martin Camaj e cila vijon me punën studimore rreth çështjeve të gjuhësisë, punë që ka filluar gjatë viteve '60 kur ai jetonte në Romë, ku ai zhvilloi një veprimtari të dendur, sidomos si kryeredaktor i revistës "Shejzat".

Ndërsa studiuesi i veprës së Martin Camajt, Bardhyl Demiraj rrëfen se "Camaj solli një ndihmesë të vyer me studimin e historikut të shqipes nëpërmjet disertacionit përkushtuar Gjon Buzukut, si dhe nëpërmjet zëbërthimit të veprës "Cuneus prophetarum" të Bogdanit. Peshë të veçantë kanë studimet dialektologjike të bëra nga Camaj me metodën strukturale nëpër bashkësitë arbëreshe".

Është një krijimtari me vlerë edhe ne shkencat albanologjike. Në këtë krijimtra i përfshihen monografia "La parlata albanese di Greci in provincia di Avellino" (botuar në Firence më 1961); "Die albanische Mundart von Falconara Albanese in der Provinz Cosenza" (botuar në Mynhen më 1977) dhjetëra përshkrime të krijimeve dialektore italo-shqiptare, ndër të cilat po veçojmë: "Zur Albanischen Mundart von Barile in der Provinz Potenza" (botuar në Mynhen më 1971), "Per una tipologia dell'arberesh" (botuar në Palermo më 1982), e të tjera.

Nga mesi i viteve '60, Martin Camaj shkon të jetojë sërish në Mynhen, ku u punësua si mësime universitar i gjuhës shqipe dhe aty botoi librin "Lehrbuch der Albanischen" si dhe monografinë "Albanische Wortbildung", me një përmbajtje inetrante për fjalëformimin e shqipes, e cila merret me çështjet e ndërlikuara të trajtave dhe etimologjive shqipe.

Ai ka botuar edhe librin "Albanian Grammar" rreth strukturës gramatikore të shqipes në tri krijimet e saj, d.m.th në gegërisht, toskërisht dhe në arbëreshe. Kjo vepër përmban pjesë të zgjedhura nga Buzuku e Matrënga, Budi e Bogdani, Variboba e De Rada, Hasan Zyko Kamberi e Naim Frashëri, Skiroi e Mjeda, Fishta e Konica, Asdreni e Fan Noli, Koliqi e Migjeni, Xoxa e Gajtani.

Martin Camaj ka sjellë një ndihmesë të madhe edhe në rrafshin e studimeve të folklorit, ku ai bëri një punë të jashtëzakonshme si docent i Albanologjisë në Universitetin e Mynhenit, e më vonë si shef katedre.

Redaksia

NDERIMI DHE MIRËNJOHJE - Vlerësohet puna e gazetarëve të Shkodrës

Para pak ditësh në ambientet e bibliotekës "Marin Barleti" në Shkodër, u promovua një aktivitet krejtësisht i veçantë në llojin dhe tematikën e tij, që e bënë atë të nderohet e vlerësohet jo vetëm nga pjesëmarrësit, por edhe nga opinioni i gjërë intelektual e qytetar shkodran e më gjërë.

Ky aktivitet u organizua nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, por me iniciativën dhe përkujdesjen e degës së këtij Unioni në Qarkun e Shkodrës, ku natyrisht meritat kryesore i ka kryetari i këtij Unioni z.Gaspër Marku, si ideator dhe realizues i edicionit të parë të këtij konkurimi.

Qëllimi i këtij aktiviteti nuk ishte analiza dhe diskutimet që gazetarët mund të bëjnë për punën e tyre, por ishte nderimi për punën që ata kanë bërë në pasqyrimin me vërtetësi dhe profesionalizëm të jetës shoqërore, ekonomike, shkencore, kulturore, artistike e sportive, jo vetëm në Shkodër, por edhe më gjërë.

Natyrisht, që ky nderim të ishte evident në këtë aktivitet, organizatorët kishin menduar të akordonin një çmim shumë të lavdërueshëm për penat më të mira. Çmimi "Hamit Boriçi" do t'i jepej kështu autorëve më të mirë të gazetarisë për gjini të ndryshme të mediave të shkruara dhe audiovizive.

Në këtë ambient kaq të ngrohtë dhe shoqëror ishte i pranishëm edhe vetë mjeshtri dhe një ndër themeluesit e gazetarisë shqiptare Prof. Dr.Hamit Boriçi, i cili i mallëngjyer dhe i emocionuar u shpreh: "Në qoftëse unë kam bërë diçka të mirë që në fillim, e kam bërë për tre personalitete: Shaqir Boriçi, Adem Boriçi dhe Muhamet Bala, i cili ka qenë edhe drejtori i parë i kësaj biblioteke. Prania ime sot dhe vlerësimi i madh që po më bëni iu përket edhe atyre".

Aktivitetin e hapi kryetari i Unionit të Gazetarëve Dega Shkodër z.Gaspër Marku që në fjalën e tij vuri në dukje punën e mirë dhe profesionale të të gjithë gazetarëve, por theksoi në mënyrë të veçantë angazhimin e penave të reja që kanë hyrë me shumë meritë në fushën e krijimtarisë të botës së shtypit, radios e televizionit.

Më pas, të pranishmit i përshëndeti edhe kryetari i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë z.Aleksandër Çipa dhe sekretarja e këtij Unioni znj.Anila Basha. "Nisma e Unionit të Gazetarëve të Qarkut të Shkodrës përbën një hap që shënon atë që ne e konsiderojmë të munguar në shoqërinë e trazuar të sotme shqiptare, referencat, ato që ne i shpërfillim herë me dashje dhe herë pa dashje", tha ndër të tjera kreu i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, Aleksandër Çipa. Ndërsa, sekretarja e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë znj.Anila Basha, në fjalën e saj shprehu konsideratat më të mira për të gjithë punën e bërë nga gazetarët shkodranë, por vlerësimin më të madh ia dedikoi organizatorit dhe ideatorit të këtij aktiviteti z.Gaspër Marku, i cili me punën e bërë ka dhënë një kontribut të shquar që ky

Union të meritojë mirënjohje e respekt nga masat e gjëra të popullit në Shkodër, Malësinë e Madhe, Pukë, Mirditë e më gjërë.

Siç thamë edhe më lart organizatorët kishin përzgjedhur, bazuar në veprimtarinë e secilit gazetar në fusha të ndryshme më të dalluarit, më aktivët, për t'i nderuar me çmimin "Hamit Boriçi".

Përpara se të kalohej në ndarjen e

madan Bigza dhe Mejdan Zhivani.

Por surprizat nuk kishin të mbaruar me kaq. Mirënjohja do të vinte edhe për personalitete të tjera që kanë kontribuar në këtë fushë ku respekt dhe mirënjohje u akordua edhe për dy personalitete të medias në SHBA, fillimisht për z. Ndue Ftoni; si një bashkëatdhetar i shquar, që me kontributin e tij prej vitesh, duke mos i shkëputur kurrë lidhjet me vendlind-

jo vetëm nuk i ka shkëputur asnjëherë lidhjet me Shqipërinë, por nëpërmjet televizionit ACTV në Michigan dhe portalit www.AlbDreams.Net, është bërë një tribunë që përçon në të gjithë Diasporën Shqiptare vlerat kulturore, artistike dhe historike të të gjithë kombit shqiptar.

Këtë takim në shtëpinë e librit, bibliotekën "Marin Barleti" e kishin vlerësuar edhe personalitete të shquara si: shkrimtarë, artistë, deputetë dhe drejtues të pushtetit vendor.

Përpos çmimeve të konkursit, drejtuesit e unionit të gazetarëve shqiptarë kanë shpërndarë certifikata mirënjohje edhe për dy gazetarët e karrieres, Zana Dibra dhe Lekë Plani, si dhe autorit të këtij shkrimi, gazetarin e kulturës Ramazan Çeka për pasqyrimin me vertetësi dhe profesionalizëm të aktiviteteve kulturore dhe artistike në Shkodër, në Shqipëri dhe në të gjitha trevat shqiptare.

Ndërkohë, në kuadrin e konkursit, Çmimi "Hamit Boriçi"-Edicioni i parë 2017, fitues në zhanre të ndryshme janë shpallur: Adrian Hoti, si "Prezantuesi më i mirë, i edicioneve informative, në televizionet e Shkodrës", Anila Dushi për "Reportazhin më të mirë në median e shkruar", Emi Kalaja për "Dokumentarin më të mirë televiziv në mediat vizive të Shkodrës", Ardi Hoti për "Gazetarinë investigative televizive", Ergys Kavaja për "Kroniken më të mirë televizive në fushën sociale", Elvis Nabolli për "Raportimin më të spikatur në lidhje të drejtpërdrejtë nga terreni", Bepin Kolvata "Për kronikën më të mirë në fushën e kulturës", Simon Shkreli për "Mbulimin më të mirë mediatic në hapësirën e trojeve shqiptare", Sokol Pepushaj për "Gazetarinë investigative të medias së shkruar", Bes Jacaj me çmimin inkurajues për gazetarët e rinj me perspektivë të mediave të Shkodrës.

Vetë gazetarët në fjalët falenderuese shprehën mirënjohjen për vlerësimin që u ishte bërë, duke e quajtur këtë çmim edhe si një obligim për të qenë sa më pranë problemeve dhe halleve të përditëshme, por edhe të ngjarjeve të mëdha që kanë interes për opinionin e gjërë shqiptar.

"Një çmim në gazetari ka shumë vlera qytetare dhe intelektuale për Shkodrën. Kjo veprimtari dhe çmimi "Hamit Boriçi" janë një shtysë për zhvillimin e mediave si dhe zhvillimin ekonomik - kulturor në Shkodër". Ky ishte opinionin i të pranishmëve në këtë takim.

Kënaqësi të veçantë ndjenë të pranishmit pas ceremonisë zyrtare kur u bashkuan në një koktejl të pasur në ambientet e "Grand Hotel Europa".

Bashkëbisedimet, humori dhe batutat shkodrane, muzika dhe fotografitë e bënë më të gëzueshëm këtë veprimtari, duke e bërë të paharruar për pjesëmarrësit.

Redaksia



çmimeve përkatëse, me emocion u priten nga pjesëmarrësit edhe shpërndarja e certifikave të mirënjohjes për gazetarët e ndarë nga jeta kohët e fundit, si ndaj gazetarit dhe operatorit Nexhat Rakaj, komentatorit dhe kronistit sportiv Ymer Striniqi dhe dy gazetarëve sportivë, Ra-

jen, ka krijuar në SHBA një "Mecenat" ku mblidhen dhe përçojnë kulturën shqiptare artistët më të shquar të të gjithë kombit tonë. Një tjetër vlerësim ishte edhe për publicistin e shquar shqiptaro-amerikan z. Rush Dragu që iu akordua gjithashtu çmimi i mirënjohjes, që

“SHQIPTARËT NË TOKËN E ËNDRRUAR”

PROMOVOHET LIBRI MË I FUNDIT I SHKRIMTARIT DHE PUBLICISTIT RUSH DRAGU

Këto ditë, kur pranvera u bë më në fund e pranishme në qytetin e Shkodrës, biblioteka “Marin Barleti” hapi dyert e saj mikpritëse për një mik që kishte ardhur nga larg dhe që kishte sjellë në qytetin e tij, jo vetëm thjesht një libër për ta promovuar, por kishte sjellë bashkë me të edhe një pjesë të punës së tij si shkrimtar dhe publicist për bashkëkombasit në vendlindje dhe në Amerikën e largët ku jeton. “Shqiptarët në tokën e ëndrrave” është një përmbledhje dhe pasqyrim i punës së tij të palodhur, ku nëpërmjet intervistave dhe bashkëbisedimeve me bashkëatdhetarët tanë në Amerikë bën publike kontributin e tyre, jo vetëm në komunitetin ku jetojnë, por edhe lidhjen e këtij komuniteti me atdheun e tyre. Ky ishte qëllimi i këtij libri me vlera të mëdha njohëse, patriotike, kombëtare dhe edukative.

Në këtë shkrim ne nuk marrim përsipër të bëjmë analizën e librit. por e ndjejmë për detyrë për t’i treguar lexuesit se është një libër me vlera, jo vetëm për punën e mirë që ka bërë autori, por edhe për mesazhet që ai përcjell përmes intervistave që sjell në të me mendimet dhe opinionet e bashkëbiseduesëve të tij.

Rush Dragu ka rreth 20 vite që jeton në SHBA. Ai ka lindur në një nga trevat më të shquara të Shqipërisë së Veriut, në Kelmend të Malësisë së Madhe dhe që në rini, falë aftësive të tia intelektuale, pasionit për letërsinë dhe trashëgimisë patriotike të familjes dhe të krahinës, ka qenë një nga djemt e kësaj zone që ka bërë emër, fillimisht si nxënës dhe student dhe më pas edhe si mësues dhe drejtues shtetëror në Malësi.

Pra rreth 20 vite më parë, si shumë shqiptarë të tjerë edhe Rush Dragu gjen “tokën e ëndrrave”, Amerikën e largët, ku nuk shkon thjeshtë për të punuar e kaluar jetën, por ku i vë për detyrë vetes të çojë atje një pjesë nga Shqipëria, por edhe të sjellë në atdhe kontributin e madh të bashkëatdhetarëve që në çdo çast kujtojnë, lavdërojnë dhe evidentojnë vlerat e atdheut të tyre.

Kjo del më së miri nëpërmjet shkrimeve të tija tek libri “Shqiptarët në tokën e ëndrrave”.

Salla e madhe e Bibliotekës “Marin Barleti” në këtë ditë pranvere ishte mbushur plot dhe drejtori i këtij institucioni z.Gjovalin Çuni i uroi mirëseardhjen të gjithë pjesëmarrësve dhe u shpreh se është i lumtur që ka rastin të presë një mik të nderuar që vjen nga larg.

Kryetari i Shoqatës së Shkrimtarëve të Shkodrës Skënder Temali, pas fjalës përshëndetëse të mirëseardhjes, nga drejtori i këtij institucioni z.Gjovalin Çuni, bëri një prezantim shumë emocionues, jo vetëm për librin “Shqiptarët në tokën e ëndrrave”,



por edhe për autorin e tij, shkrimtarin dhe publicistin Rush Dragu.

Fjala e tij rreth biografisë dhe veprës së autorit, kishte vlera të mëdha, në mënyrë të veçantë për një grup të rinjsh pjesëmarrës, aspirues të kësaj fushe, që nuk ishte i vogël.

Çdo diskutim, opinion dhe vlerësim nga të pranishmit u mirëprit me duartrokitje, sepse siç u shprehen ata, ky libër i Rush Dragut solli në Shkodër informacione shumë të rëndësishme, që lidhen me të kaluarën dhe me të tashmen e shqiptarëve në të gjitha trojet ku jetojnë. Ky djalë nga Malësia e Kelmendit, në veprën e tij ia rriten vlerat Malësisë dhe maleve kreshnike dhe tregon se si malësorët arrijnë të prekin majat e suksesit me punë e ndershme, me përpjekje, durim e qendresë, duke bashkuar dy botë aq të largëta, por që në mediat ku punon Dragu i af-

ron shumë pranë Amerikën dhe Malësinë. Ndërmjet tyre mund të përmendim vlerësimet që erdhën nga studiues, shkrimtarë dhe poetë, si Ndue Bacaj, historian, Fatbardha Behri, (Kaçi), poete, Mimoza Reçvelaj, poete, Kadri Fikaj, studiues, prozator dhe poet.

Një përshtypje të veçantë u la të pranishmëve fjala e gazetarit të mirënjohur shkodran Gaspër Marku, Kryetar i Unionit të Gazetarëve të Shkodrës, i cili dhe në emër të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë dhe kryetarit të tij z.Aleksandër Çipa, falenderoi z.Rush Dragu, jo si një mik, por si një djalë malësor e shkodran, që me veprën e tij dhe punën që bën, atje ku jeton e punon, asnjëherë nuk harron të jetë i pranishëm, por dhe i nderuar në vendlindje.

“Këtu kam lindur, këtu jam rritur e arsimuar, këtu kam krijuar për herë të parë, ky është vendi që më ka mësuar dhe më ka dhënë emër, prandaj zemra dhe kontributi im do të jenë gjithmonë këtu”, u shpreh ndërmjet të tjerave në fjalën e tij shumë i mallëngjyer Rush Dragu.

Promovimi i librit kishte edhe personalitete dhe miq të autorit si Sytki Ndreca, nënkryetar i Bashkisë së Malësisë së Madhe, si dhe Luigj Dodaj, ish tranier i ekipit të futbollit të Laçit, që është edhe një ndër personat e intervistuar në këtë libër.

Z. Gaspër Marku me autoritetin e kryetarit të gazetarëve shkodranë, në emër të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë e surprizoi këtë burrë të nderuar që kishte ardhur nga Amerika, duke i dorëzuar atij një çertifikatë mirënjohëse që ishte një nderim, jo vetëm i gazetarëve, por i gjithë vendlindjes, duke mos harruar edhe një tjetër protagonist shkodran me shumë vlera dhe kontribute, z.Ndue Ftoni, biznesmenin e fuqishëm nga Dukagjini, që edhe pse nuk është vetë autor, është një mbështetës dhe financues për kulturën dhe artin shqiptar në Atdhe dhe në SHBA.

Çertifikatën e mirënjohjes, për z. Ndue Ftoni, i cili nuk merrte pjesë në këtë promovim, unë autori i këtij shkrimi, pata nderin t’ja dorëzoj mikut tim Rush Dragu, duke e porositur atë që bashkë me këtë çertifikatë, të transmetojë edhe falenderimet e mia per-

sonale, por edhe të gjithë të pranishmëve.

“Ti ke intervistuar shumë njerëz me vlera në librin tënd, e sot ndjehesh i intervistuar” iu drejtua një moment me humor z. Skënder Temali, autorit të librit që i kishte mbledhur në Bibliotekën e Shkodrës.

“Po, iu përgjigj z. Dragu, por kjo me të marrë në intervistë qenka më e vështirë, pasi jam kaq i mbushur me emocione dhe kaq i befasuar nga pritja që më keni bërë, sa nuk di nga t’ja filloi më parë”.

Organizime dhe promovime të tilla në Shkodër nuk janë të rralla, sepse në Shkodër krijimtaria artistike-letrare është e gjallë.

Ata nuk vijnë spontanisht, por tregojnë se Shkodra ka talente, autorë të rinj dhe profesionistë që krijojnë ashtu siç ka qenë gjithmonë traditë.

Këta nuk janë si dikur në bazë të një plani apo programi, por lidhen me pasionin dhe dashurinë për artin dhe letërsinë.

Biblioteka “Marin Barleti” është si të thuash shtëpia e madhe shkodrane e prezantimit të këtyre vlerave dhe natyrisht, meritë të veçantë ka drejtori i saj profesori i letërsisë z.Gjovalin Çuni.

Emocione solli në këtë takim edhe aktorja e Teatrit “Migjeni” Rajmonda Marku, e cila interpretoi fragmente nga libri “Shqiptarët në tokën e ëndrrave”.

Ceremonia e promovimit të librit u mbyll me një koktejl që kishte vlerat e një sofrit të mbushur me miq, të cilët patën rastin që në bashkëbisedimet e tyre të njihen më gjërë me krijimtarinë e atij që i kishte mbledhur, por edhe me planet që vetë ata kanë në krijimtarinë e tyre.

Natyrisht ky aktivitet u regjistrua dhe u transmetua nga mediat lokale dhe bëri një jehonë të madhe, jo vetëm tek teleshikuesit shkodranë, por edhe më gjërë.

Nga RAMAZAN ÇEKA



Një nga bizneset të suksesshëm Ndue Ftoni, Miçigan SHBA



REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi
Botimin:
NDUE FTONI

